

E PËRDITSHME
E PAVARUR

Drejtor:
FAHRI BALLIU
Kryeredaktor:
ILIR NIKOLLA

Nr. 6072
Viti XVIII i botimit
(numri i parë doli
më 18.10.1997)

E enjte,
16 prill 2015

55

Adresa: Rruga
"Medar Shtylla",
qendra e biznesit

Tel: 04/2321364,
Tel: 04/2321366,
Fax: 04/2321365,
Tiranë

E-mail:
info@gazeta55.net,
gazeta55mail@
yahoo.com,
Internet:

www.gazeta55.al
Çmimi 30 lekë
Greqi 1,5 EURO

DOSSIER/16-17

1945/70 vjet nga gjyqi i parë special

Administrata e fashizmit ndihmonte ngritjen e çetave antifashiste

Nga Kastriot Dervishi



Fryma e kompromisit që kishte klasa e vjetër politike ka qenë një fakt i njohur gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri. Në vitet 1939 – 1941, pothuaj në Shqipëri nuk ka pasur asnjë lloj qëndrese. Në vitet 1942 – 1943 kjo qëndresë është simbolike dhe vetëm viti...

Të ikë Rama, jo shqiptarët

► Mijëra shqiptarë po braktisin vendin çdo muaj në një përpjekje për të shpëtuar nga mungesa e perspektivës, por të gjithë bashkë duhet të bashkohen për të çliruar vendin nga infeksioni i vërtetë. Atdheun duhet ta lërë të lirë Edi Rama dhe një aradhë ministrash të korruptuar dhe jo qytetarët e lënë të papunë dhe të braktisur në fatin e tyre

DITA

Kreu i demokratëve: "Po bllokoni procesin e dekriminalizimit. Fund i keq për atë që prek votat"

Basha: Rama, me kandidatë të inkriminuar në zgjedhje për të vjedhur votat

**Eksodi/Braktiset Shishtavec,
banorët: Po vdesim urie,
s'kemi bukë të hamë**

**Apeli i autoriteteve austriake:
Mos kërkoni azil në Austri, është
thujse e pamundur ta fitoni**

**Fotoreporterit Hamza Hatika kërkon
azil politik: "Heq dorë, jam kërcënuar
nga politikanët e qeverisë"**

**Mandati i Kokëdhimës/PD:
"Mazhoranca ka vendosur të bllokojë
shqyrtimin e Gjykatës Kushtetuese"**



Kreu i PD prezanton Grida Dumën si kandidate për Bashkinë e Durrësit

A di Zoti shqip?

Nga Gani Mehmetaj

Hoxhallarët, Bashkësia Islame e Kosovës, me bashkësitë simotra në Shqipëri, Maqedoni e Kosovën Lindore duan të na bindin se Zoti nuk di shqip. Sipas tyre, Perëndia e kupton vetëm gjuhën arabe, prandaj të gjitha lutjet, ritualët dhe ceremonitë mortore bëhen në gjuhën arabe. Kundër bindjeve të ngulitura thellë në etnopsikologjinë shqiptare se filani...

**Trajtimi i Maqedonisë në fillim të
Luftës së Parë Botërore nga
diplomacia evropiane**

Nga Prof.Dr.Vebi Xhemaili

Studiuesi rus Vodovozovit nga Petërburgu më 15 prill 1915 vizitoi qytetet shqiptare të Maqedonisë së sotme, ku ai pranon: "se: te ai kanë mbisunduar ndjenjat bullgarofile", por në rastin konkret pranon se: "qytetet që ka vizituar janë qytete me shumicë shqiptare dhe duhet t'i takojnë Shqipërisë..."

Basha: Oferta e re për Durrësin vjen me bijën dhe intelektualen e qytetit

FORUM

**70 vjetori i gjyqit
special/Kolaboracionist
apo patriot?**

Nga Reshat Kripa

Në 70 vjetorin e gjyqit special natyrshëm të lind pyetja: Çfarë kanë qenë personazhet që aktivizoheshin në administratën shtetërore në periudhën e Luftës së Dytë Botërore, kolaboracionist apo patriot? Kjo pyetje qëndron pezull në skakierën e politikës...

Në 70 vjetorin e përmbytes
së Shqipërisë

**A kanë ideal
komunistët?**

Nga Fritz Radovani

HAPNI DOSJET! Aty keni me gjetë edhe "ideal" e këtyne dy miqëve! - Kur shkoi në Francë për studime Enver Hoxha deklaroi: "Unë do bëhem terrorist!..."

**Politika e
jashtme turke:
një strategji e
paqartë**

Nga Didier Billion

Recep Tayyip Erdogan u prit më prill nga homologu i tij iranian Hassan Rohani. Megjithë pikat e mosmarrëveshjeve politike...

Kreu i PD prezanton Grida Dumën si kandidate për Bashkinë e Durrësit

Basha: Oferta e re për Durrësin vjen me bijën dhe intelektualen e qytetit

Grida Duma është kandidatja e koalicionit të djathtë për Bashkinë e Durrësit, ku do të garojë përballë Vangjush Dakos të së majtës. Zyrtarizimi i saj u bë nga kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, në qytetin ku ajo do të garojë. Basha tha se kandidatura e Dumës që ka gjetur dhe mbështetjen e aleatëve dhe është oferta e opozitës për një ndryshim të ri për durrsakët.

Grida Duma: Ka ardhur koha për t'i kthyer dinjitetin Durrësit dhe durrsakëve

Partia Demokratike ka shpallur dje në Durrës, kandidaten për kryetare Bashkie, znj. Grida Duma. Kryetari i Partisë Demokratike, tha se kjo është një ditë e bukur për Durrësin. "Është një ditë e bukur për qytetin e Durrësit, për qytetarinë e Durrësit, kësaj qendre të vjetër, krenarisë tonë kombëtare, dhe gjithë Bashkisë së re të Durrësit. Është një ditë e bukur për demokratët, mbështetësit e tyre dhe aleatët tanë. Sot është dita kur shpallim kandidaturën tonë, kandidaturën e qytetarëve për një Durrës qytetar, europian dhe modern. Me demokratët këtu në Durrës dhe anëmbanë Shqipërisë kemi premtuar një ofertë të re, një ofertë të re sepse koha nuk pret më, sepse njerëzit duan ndryshim, të djathtë dhe të majtë, sepse në Durrës e anëmbanë Shqipërisë janë

të pakënaqur me situatën. Ndryshimi vjen përmes ofertës së re. Oferta e re vjen përmes bashkimit të kontributeve më të mira, identifikimit të vlerave më të mira, reputacionit më të mirë të bijëve dhe bijave më të mira të Durrësit dhe shtrirjes së kësaj oferte si një zgjidhje, si një mundësi për të shpëtuar Durrësin. Për të shpëtuar Durrësin nga darta e mjerimit, e arrogancës, e shtypjes, e pamundësisë, e papunësisë, e eksodit, e mashtrimit që ka ardhur si e vetmja ofertë e Edi Ramës dhe Ilir Metës dhe përfaqësuesit të tyre betonist këtu në Durrës. Oferta jonë e re ka pasur disa personalitete dhe disa fytyra mbi të cilat është bazuar, njëri më dinjitoz se tjetri. Por zgjedhja e Partisë Demokratike dhe aleatëve tanë pa asnjë rezervë shkon tek një bijë Durrësi, tek një vajzë



Durrësi, tek një nënë Durrësi, tek një fytyrë emblematike e nisjes së re të demokratëve, te një intelektuale e kalibrit europian, tek një akademike e shkëlqyer, studiuese, politikane e dashur dhe e admiruar nga të gjithë shqiptarët, administratore e sprovuar, bija juaj, kandidatja juaj dhe kryetarja e ardhshme e bashkisë së Durrësit, Grida Duma", u

shpreh kryetari i Partisë Demokratike, Basha. Grida Duma tha se ka ardhur koha për t'i kthyer dinjitetin Durrësit dhe durrsakëve. "Po kthehem tek qyteti im i lindjes. Po kthehem sepse Durrësi meriton t'i kthehet qytetaria. I kanë gjykuar durrsakët si të frikshëm në votime dhe në zgjedhje, sepse penalizojnë fort me heshtje në mënyrën më qytetare, atëherë kur nuk

ka vlera. Unë jam e bindur që sot ne do të fillojmë një etapë tjetër për Durrësin, për ata qytetarë që e ndiejnë gjithnjë në gjak, por edhe për ata qindra mijë që kur kanë ardhur këtu e kanë parë si shpresë. Do kthejmë shpresën e metropolit të dytë të Shqipërisë. Do kthejmë fitoren që e meriton Durrësi, duke i kthyer mirënjohjen Partisë demokratike që ma dha shansin për të kërkuar besimin tuaj dhe e di që do ta kem", u shpreh Duma. Kryetari Basha komentoi edhe për figurën e Agron Dukës. "Siç e dini në garën për Durrësin, përveç figurave dinjitoze të PD, pati edhe një kandidaturë dinjitoze të aleatit tonë, Partisë Republikane, dhe kjo figurë dinjitoze është Agron Duka. Duke vlerësuar maksimalisht

dhe me pozitivitet ofrimin e figurës së tij, duke vlerësuar po kështu bashkimin pa rezerva e të fuqishëm të Partisë Republikane dhe të Agron Dukës në mbështetje të kandidaturës së Grida Dumës si një garanci shtesë për një fitore të thellë në bashkinë e Durrësit, dua të siguroj të gjithë mbështetësit tanë se gara që na pret nuk ka për qëllim fitoren e PD, nuk ka për qëllim fitoren e opozitës, por ka për qëllim fitoren e çdo qytetari të bashkisë së re të Durrësit, mirëqenien e çdo qytetari të bashkisë së re të Durrësit; ka për qëllim shpëtimin e Durrësit nga darta e mjerimit, ka për qëllim shpresën që lind dhe do të lind nga Durrësi me Grida Dumën dhe me ju të gjithë qytetarët e ndershëm të këtij qyteti", tha Basha.

Eurodeputeti kroat, Plenkoviç: Monitorim të rreptë të kandidatëve, nëse ata kanë precedentë apo të dhëna kriminale

"Partitë politike të distancohen nga fenomenet korruptive dhe kriminale – kjo është sfidë edhe për shoqërinë"

Në një intervistë ekskluzive për ABC News, zëvendëskryetari i Komisionit të Punëve të Jashtme të Parlamentit Europian, Andrej Plenkoviç ka deklaruar, se Shqipëria nuk duhet të sjellë pengesa në rrugën e saj drejt anëtarësimit Europian. Sipas tij, qeveria dhe opozita duhet të angazhohen për forcimin e shtetit ligjor, luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit. Plenkoviç flet edhe për shqetësimet e ngritura nga Partia Demokratike, rreth zbatimit të marrëveshjes politike të 24 dhjetorit, për dekriminalizimin. Eurodeputeti kroat thekson se personave me rekorde kriminale të zgjedhur në poste shtetërore, tu hiqet imuniteti për t'ju nënshtruar një procesi gjyqësor. Sipas tij, është esenciale që filtrat brenda partive të bëjnë një monitorim shumë të rreptë të kandidatëve, nëse ata kanë precedentë

apo të dhëna kriminale.

Gjatë debatit për rezolutën për Shqipërinë, ju u ndalët te nevoja për të evituar kulturën konfliktuale politike në Shqipëri. Në ç'masë kjo marrëdhënie konfliktuale influencon imazhin e vendit?
Së pari, si eurodeputet kroat dhe zëvendëskryetar i Komisionit të Punëve të Jashtme të Parlamentit Europian, unë mbështes fort integrimin europian të Shqipërisë, statusin e kandidatit dhe shpresoj që të arrihet në një shkallë të progresit, ku mund të flasim për hapjen e negociatave. Mendoj, gjithashtu se ç'ka do ta ndihmonte shumë imazhin e vendit është ngritja në një nivel më të lartë të debatit midis mazhorancës dhe opozitës në Shqipëri, në përputhje me standardet europiane dhe mënyrën se si partitë politike komunikojnë në Europë. Shpresoj që të

arrihet progres në këtë.

Ndërkohë, edhe pse në rezolutën e Knut Fleckenstein nuk u përfshinë çështjet e mpresha politike si ajo e Mark Frrokut, fakti është që për fshehjen e kërkesës së ekstradimit të autoriteteve belge, dha dorëheqjen shefi i policisë shqiptare dhe u arrestuan dy zyrtarë të Interpolit Shqiptar. Ju jeni njohur gjithashtu më parë me çështjen Doshi dhe ndërkohë flitet për një listë deputetësh me precedentë kriminale në Parlamentin Shqiptar. Ç'mendoni për situatën politike në vend dhe ç'impakt ka ajo për reformat e integritetit në vend?
Në këtë kuadër është shumë i rëndësishëm zbatimi i marrëveshjeve të nënshkruara nga Shqipëria për bashkëpunimin e ndërsjellë me shtetet anëtare. Shqipëria është

gjithashtu vend anëtar i Këshillit të Europës që ka një numër të madh konventash dhe marrëveshesh për të përbushur kërkesat e vendeve të tjera europiane veçanërisht kur ato janë të argumentuara mirë. Lidhur me perceptimin politik për vendin, duhen evituar të gjitha elementet që mund të dëmtojnë kredibilitetin e Shqipërisë si një vend kandidat për anëtarësimin në Bashkimin Europian. Kjo bëhet përmes forcimit të shtetit ligjor, luftës kundër krimit të organizuar, korrupsionit. Këtu ka një rëndësi të veçantë linja që merr qeveria dhe partitë politike jo vetëm duke u distancuar nga fenomene të tilla, por duke vepruar konkretisht kundër tyre. Kjo është një sfidë e vërtetë e qeverisë dhe shoqërisë shqiptare në vitet që vijnë.

Parlamenti Europian ndërmjetësoi Marrëveshjen e Dhjetorit për t'i dhënë fund bojkotit të

opozitës, ku përfshihet edhe dekriminalizimi. A mendoni se brenda paketës së dekriminalizimit çështja që duhet trajtuar me rëndësi, është mostolerimi i personave me precedentë kriminale në listat e partive për të evituar që këta persona të kenë poste publike?
Kur persona të tillë zgjidhen përmes një procesi zgjedhor, nuk ka mundësi tjetër përveç heqjes së imunitetit për t'ju nënshtruar një procesi gjyqësor. Por ajo që është esenciale në këtë drejtim, janë filtrat brenda partive politike dhe një monitorim shumë i rreptë për të verifikuar se cilët janë kandidatët në listat e zgjedhjeve, nëse ata kanë precedentë apo të dhëna kriminale. Sigurisht që për persona që kanë një bagazh të tillë, e vërteta herët a vonë del në shesh.

Shumica e amendamenteve

të paraqitura për rezolutën për Shqipërinë kanë të bëjnë me shqetësimin për nivelin e lartë të korrupsionit, të krimit të organizuar dhe dobësinë e gjyqësorit për të luftuar korrupsionin edhe vetë brenda sistemit të drejtësisë. A është progresi në këto tre kritere nga pesë që duhet të përbushë Shqipëria për hapjen e negociatave?
Është shumë e rëndësishme që të fillohet seriozisht me reformat e shtetit ligjor, të drejtave themelore, sigurisë dhe gjyqësorit, pasi këto janë kapitujt më delikatë të procesit të negociatave të anëtarësimit. Këto kritere janë ato që për Komisionin Europian dhe shtetet anëtare tregojnë nëse një vend funksionon siç duhet apo jo. Kroacia ka kaluar përmes këtij procesi. Janë kapitujt 23 dhe 24. Këto përbëjnë testin e vërtetë për kredibilitetin e një vendi.

Të ikë Rama, jo shqiptarët

Mijëra shqiptarë po braktisin vendin çdo muaj në një përpjekje për të shpëtuar nga mungesa e perspektivës, por të gjithë bashkë duhet të bashkohen për të çliruar vendin nga infeksioni i vërtetë. Atdheun duhet ta lërë të lirë Edi Rama dhe një aradhe ministrash të korrumpuar dhe jo qytetarët e lënë të papunë dhe të braktisur në fatin e tyre

Eksodi i shqiptarëve është shndërruar edhe njëherë tjetër si ngjarja më alarmante që përsëritet brenda 24 viteve. Çdo ditë e më tepër raportohen shifra të frikshme të shqiptarëve të zgjedhin të braktisin vendin në kërkim të statusit të azilantit në vendet e BE. Raporti i publikuar dy ditë më parë nga autoritetet policore gjermane se Shqipëria po konkurren denjësisht Sirinë në luftë, për numrin e lartë të qytetarëve emigrantë, ku vetëm brenda muajit mars 2015, nga Shqipëria janë larguar më shumë se nga Afganistani, Iraku dhe Bosnja, madje po të kemi parasysh se Siria ka 18 milion banorë e Shqipëria 3 milion, Shqipëria ia kalon edhe Sirisë në luftë, është vetëm maja e ajsbergut që flet për të dhëna tragjike. Edhe dje nga qytete të ndryshme të vendit u raportuan largime të qytetarëve, të cilët braktisin Shqipërinë në një rrugë pa kthim si rrjedhojë e mungesës së shpresës, papunësisë, varfërisë, pesimizmit për

të ardhmen nga qeverisja e klasifikuar si qeverisje e "oligarkisë, banditizmit, korrupsionit dhe kriminimit në politike...". Ka një dhe vetëm një përgjegjës për situatën e dhimbshme të qytetarëve që braktisin gjithçka në këtë vend, në kërkim të një jete më të mirë në vendet e BE, por këtë e bëjnë vetëm duke tentuar azilin politik atje. Përgjegjësi direkt për shndërrimin e Shqipërisë në vendin më problematik për numrin e lartë të azilantëve është kryeministri Edi Rama dhe shpura e tij qeverisëse e zhytur në korrupsion dhe kriminalitet. Fajtor për gjendjen e rëndë ekonomike, varfërinë, papunësinë dhe humbjen e besueshmërisë tek institucionet ligjzbatuese, pasi është krimi ai që i kontrollon institucionet dhe të gjithë shtetin. Shqiptarët po largohen çdo ditë, duke zgjedhur rrugën e emigrimit përballë situatës katastrofike ekonomike, sociale dhe politike ku e ka zhytur vendin kryeministri që



po përgatitet të marrë "1 milionë shkelmat". Por, kjo situatë me pasoja tragjike për Shqipërinë dhe kombin shqiptarë, duhet parandaluar sa të mos jetë vonë. Vendi i zhytur në një krizë politike të pashembullt ku ligjin e bëjnë kriminelët, ekziston një rrugëzgjdhje optimale që është vota e lirë dhe demokratike e

shqiptarëve në zgjedhjet bashkiake, të cilat pa më të voglin dyshim që do të jetë edhe pikënisja e ndryshimeve të mëdha politike në Shqipëri. Ekziston një apel mbarëkombëtarë tashmë dhe për një çështje kaq sensitive siç dinjteti i qytetarëve pjesë e të cilës është bërë edhe kleri fetar, duhet vlerësuar dhe

mbështetur maksimalisht. Në 21 Qershor duhet votuar me vullnet të plotë kundër kandidatëve të inkriminuar të cilët Edi Rama po i rehabiliton edhe në krye të pushtetit vendor tashmë. Duhet zhbërë e gjithë kjo energji negative që ka pllakosur të katër anët e vendit në 19 muaj qeverisje të Edi Ramës. Dhe kjo arrihet me vullnetin e përbashkët që domosdo duhet shprehur fillimisht në 21 Qershor, duke refuzuar kategorikisht kandidatët e inkriminuar të Ramës. Vota ndëshkuese e 21 Qershorit për qeverinë oligarkike, padyshim që është votë ndëshkimi direkt për Edi Ramën gjë e cila afron gjithnjë e më tepër datën e zgjedhjeve të parakohshme. Këtë mund ta bëjë vullneti i pandalshëm i shqiptarëve dhe për arritjen e këtij qëllimi asnjë nga ne nuk duhet t'i kalojë kufijtë me mendjen për të mos u kthyer më. Kjo është e pafalshme për secilin prej nesh, pasi asnjë mënyrë vendin tonë, shpresën dhe të ardhmen tonë dhe të brezave

në vijim, nuk mund ta lëmë në dorë të shpures oligarkike që fërkon duart pas çdo shqiptari që braktis Shqipërinë për të mos u kthyer më. Vendi jonë është këtu dhe duke përsëritur fjalët e zyrtarit të policisë austriake apeli është dhe një i vetëm: "mos ikni". "Shqipëria është në dorën tuaj, në dorën tonë, dhe jo të kastës oligarkike që ka si qëllim zhvatjen dhe kriminalizimin e shtetit në çdo qelizë". Çdo qytetar i këtij vendi që zgjedh rrugën e emigrimit pa kthim, thjesht sa i zgjat ditët Edi Ramës në pushtet dhe "përligji" planin e tij për masivizimin e kriminimit në institucione. Ai që duhet të ikë 1 orë e më parë nga Shqipëria është Edi Rama dhe shpura e tij kriminale. Janë këta që po sillen si okupatorë ndaj shqiptarëve që duhen asgjësuar politikisht. Dhe me këtë, sërish nderi më i madh i bëhet Edi Ramës, pasi ndryshe nga qytetarët e thjeshtë, ai do ta ketë më të lehtë të pajiset me statusin e azilantit në një prej vendeve të BE.

Eksodi/Braktiset Shishtavec, banorët: Po vdesim urie, s'kemi bukë të hamë

Situata mjaft e rënduar në vend si pasojë e largimeve të shumta nga Shqipëria ka prekur edhe Shishtavec në Kukës. Largimet masive të shqiptarëve drejt vendeve të Bashkimit Europian në kërkim të një jete më të mirë po aplikohet nga qytetarët gjithnjë e më të shumtë në numër. Pas Orikumit, Shishtavec i Kukësit po 'zbrazet' nga banorët e tij. Me mijëra qytetarë janë nisur drejt Gjermanisë për të kërkuar azil. Banorët e kësaj zone kanë thënë se janë rreth 200 familje që janë larguar. Të gjithë këta qytetarë që largohen kanë një emërues të përbashkët, atë të varfërisë që i ka mbërthyer pa asnjë mundësi shpëtimi. Banorët tekta flasin me dhimbje për të afërmit dhe miq të tyre të larguar, kanë thënë se kushtet e vështira ekonomike i kanë detyruar këto familje të lënë banesat e tyre dhe t'i drejtohen vendeve të perëndimit, kryesisht në Gjermani. Një ndër fshatrat më problematik të këtij qarku mbetet ai i

Gores. Sipas të dhënave nga mësuesit e shkollave bëhet me dije se nën shkollën e mesme të këtij fshati sa vjen e ka më pak nxënës. "Në fshat kanë mbetur vetëm pleq, pasi të rinjtë janë larguar. Këtu partitë vijnë vetëm në fushatë, nuk duanë t'ia dinë fare. Ndaj njerëzit detyrohen të largohen për shkak të gjendjes ekonomike të vështirë", pohojnë banorët. Në këtë shkollë mësimi po bëhet në mënyrë kolektive. "Në shkollën e mesme është vetëm një nxënës i vitit të parë, ndërsa në vitin e dytë nuk ka asnjë", shprehen banorët. Ajo çka vihet re në fshatin Gore është dhe mungesa e lindjeve. Në shtatë vitet e fundit në Gore nuk ka pasur asnjë lindje. Situata dramatike për zonën. Gjithçka po i ngjet shqiptarëve është si pasojë e politikave uzurpuese të Ramës. Nuk ka vende pune, nuk ka çmime të përballeshme për qytetarët. Ka skamje në shifra alarmante, ka papunësi, ka të larguar nga puna, pasi

'militantët' partiakë janë duke pritur tek dera e partisë për të marrë shpërbllimin. Është e dhimbshme të mendosh sesi në vend nuk është marrë asnjë masë për të lehtësuar sadopak mjerimin e tyre. Qytetarët shprehen se janë të detyruar të largohen, nuk kanë me çfarë të ushqehen në vend. "Fëmijët e mi kanë ikur që të gjithë andej, qëndrojnë në kampe por të paktën kanë bukë", shprehet një prej të moshuarve. Sipas banorëve kjo situatë vijon qysh prej muajit Dhjetor, ndërkohë që largimi i njerëzve është ndierë si në bizneset e zonës ashtu dhe në shkollat e fshatit. Edhe të rinjtë tregojnë se janë larguar mjaft shokë të tyre. Më tej, ata thonë që ka dhe nga ata që kanë ikur më herët dhe janë kthyer pasi qëndrimi në kampe është i papërballeshëm, por edhe si shkak i refuzimit të azilit në këto vende. Shqiptarët po largohen drejt perëndimit, për të mos u kthyer më pas.

Gjirokastrë dhe Vlorë, ikje në masë me paketa turistike në masë/Vala e largimit na Shqipëria ka përfshirë edhe qarkun e Gjirokastrës, ku nga raportimet janë të paktën 30 familje që kanë udhëtuar drejt Gjermanisë në tre muajt e parë të këtij viti. Shumica prej tyre janë larguar përmes paketave turistike, duke u larguar në një nga vendet e BE-së dhe nga aty zgjedhin të vendosen në azilet e Gjermanisë, me shpresën se do të përfitojnë statusin e azilantit. Punonjësit e agjensive turistike kanë deklaruar se gjatë tre muajve të parë të këtij viti, numri i personave të cilët kanë emigruar drejt vendeve europiane kanë qenë të larta, ku shumica kanë tentuar "ëndrrën amerikane". Edhe Elbasani është bërë problematik sa i takon largimeve në masë të qytetarëve të tij. Midis tyre ka dhe prej komunitetit rom, që shohin si mundësi të vetme shpëtimi largimin njëherë e mirë nga vendi.

Apeli i autoriteteve austriake: Mos kërkon azil në Austri, është thujtja e pamundur ta fitoni

Vendet e BE-së shprehen të shqetësuar për rritjen e kërkesave për azil politik nga qytetarët shqiptarë. Në thujtje të gjitha vendet e bllokut europian, marrja e azilit për emigrantët ekonomikë është i pamundur. I njëjti qëndrim vjen edhe nga autoritetet austriake. Nëndrejtori i Policisë së Austrisë, Franc Lang i bëri thirrje dje azilkërkuësve shqiptarë të Shqipërisë dhe Kosovës, që të mos kërkojnë azil në Austri, pasi nuk do ta përfitojnë atë. Ai tha se si Shqipëria ashtu dhe vendet e tjera të rajonit cilësohen si vende të sigurta. Sipas tij, trafikantët janë të vetmit që përfitojnë nga udhëtimi i tyre drejt perëndimit. "Njerëzit në Shqipëri dhe veçanërisht në Kosovë e në rajon jetojnë në vende të sigurta. Ndaj nuk ka asnjë shans që ata të marrin azil në Austri apo në Gjermani. Këtë vit pritëm 50 mijë azilkërkuës, ndonëse jemi munduar tu shpjegojmë se nuk do të ketë azil për ta. Të vetmit që përfitojnë janë ata që kryejnë trafikun njerëzor, dhe kërkojnë shumë të mëdha parash. Por ata janë kriminelë dhe ne mund të themi vetëm që mos u besoni atyre, pasi premtimet që bëjnë nuk janë

të vërteta. Emigrantët mjaft të varfër si ata nga Kosova, kanë shitur gjithçka kanë dhe synojnë të marrin azil në vendet e Evropës qendrore, por ata do të dërgohen mbrapsht në vendin e tyre pa asgjë, duke qenë më të varfër seç ishin më parë", u shpreh Lang. Ai theksoi se autoritetet austriake kanë identifikuar disa prej grupeve të trafikuesve dhe janë vënë në pranga më shumë se 100 prej tyre. "Ne u themi njerëzve që qëndroni këtu, keni një vend shumë të bukur, mundësi dhe aftësi inteligjente, ndoshta më shumë se mjaft të tjerë në vendin tim. Ndërtoni vendin tuaj!" - u shpreh Lang. Problemet ekonomike janë ato që po i shtyjnë shqiptarët gjithnjë e më tepër drejt vendeve të BE. Varfëria është ulur këmbëkryq, papunësia në rritje dhe mbi të gjitha humbja e shpresës se diçka mund të ndryshojë për mirë, po i çojnë shqiptarët gjithnjë e më tepër në kufijtë e një depresioni shoqëror të pashembullt. Dhe ikja nga Shqipëria me qëllim përfitimin e azilit në një prej vendeve të BE, është e vetmja shpresë mbijetese sot për mijëra qytetarë shqiptarë.

Kreu i demokratëve: "Po bllokoni procesin e dekriminalizimit. Fund i keq për atë që prek votat"

Basha: Rama, me kandidatë të inkriminuar në zgjedhje për të vjedhur votat

Lideri i opozitës Lulzim Basha deklaroi dje se pas promovimit të individëve me rekorde kriminale, fshihet skenari i vjedhjes së votave nga ana e maxhorancës në zgjedhjet vendore. Ai tha se Rama-Meta e dinë se nuk kanë mbështetjen e qytetarëve dhe ndaj po llogarisin t'i vjedhin votat, t'i blejnë votat për t'i poshtëruar zgjedhjet. Por, kreu demokrat përcolli apelin e tij se kush guxon të prekë votën e qytetarëve, pasurinë më të madhe të popullit sovran në demokraci, i pret fundi më i keq

Kryetari i partisë Demokratike, Lulzim Basha ka deklaruar se dyshja Rama-Meta ka dalë me alternativën e krimit që blen dhe vjedh vota. Kreu Basha ka thënë mos e prekni votën pasi do ta pësoni keq. Basha gjithashtu tha se bashkimi i votës kundër kësaj dyshe të korruptuar është zgjidhja e vetme në 21 Qershor. "Beteja jonë historike për dekriminalizimin e jetës politike dhe institucionale dhe vendit, po hyn në një moment të ri, vendimtar për fatin dhe suksesin e saj. Ky është momenti i së vërtetës për të gjithë: Kush e ka bindje dhe kush e ka shtirje. Kush e ka projekt dhe kush e ka fasadë. Kush e ka seriozitet dhe kush e ka për sy e faqe. Kush e ka me vepra dhe kush e ka me mashtrime e gënjeshtër. Kush ka vendosmërinë e patundur për ta çuar përpara me çdo çmim dhe kush bën lojë të dyfishtë, duke ju hedhur hi syve ndërkombehtarëve në një anë, dhe duke u shkelur syrin miqve me rekorde kriminale në anën tjetër! Ky është momenti i qartësisë për të gjithë. Deri ku është ngjitur realisht kriminalizimi i jetës politike dhe institucionale të vendit? A është i lirë Edi Rama t'u japë duart individëve me rekorde kriminale, t'i largojë, të ndahet me ta, të mos i kandidojë në zgjedhjet vendore, të mos e mendojë më t'i emërojë në poste publike me rëndësi? Për ne, Edi Rama dhe Ilir Meta janë bashkautorët e kriminalizimit në përmasat e frikshme që ka marrë ky fenomen me ardhjen e tyre në pushtet. Kriminalizimi i ngritur në sistem është vepra e tyre e zezë", tha Basha. Më tej kreu Basha tha se "Ne nuk kemi iluzione që krimi është ngjitur në majë, duke kapur e përfshirë në vorbullën e tij të errët krerët e pushtetit. Akuzat për porositjen e vrasjes së dy deputetëve nga kryetari i Kuvendit Ilir Meta dhe për fshehjen e krimit nga Edi Rama e Saimir Tahiri po rikthehen në skenë me zhvillimet e reja që po merr e pritët të marrë ky skandal në Gjykatën e Lartë. Një mori faktesh që nuk mund të anashkalohen nga drejtësia e pavarur, përfshirë fshehjen e qëllimshme të kërkesës së Interpol Brukselit për deputetin Mark Frroku, provojnë se ka pasur vetëm një inskenim në gjithë këtë histori kriminale dhe ky është inskenimi i treshes Rama-Meta-Tahiri për të deformuar e fshirë nga faqja e dheut të vërtetën e skenarit për vrasjen e dy deputetëve. Krimi s'ka ku shkon më lart se kaq. Afrimi i zgjedhjeve vendore, përzgjedhja e kandidatëve për kryetarë bashkish dhe këshilltarë



bashkiakë, po nxjerrin në pah më qartë se kurrë, kush nuk ka asnjë kompromis me krimin – Partia Demokratike dhe opozita në përgjithësi – dhe kush po tallet me dekriminalizimin", u shpreh Lulzim Basha. Basha më tej ka folur edhe për kandidaturat e përzgjedhura nga maxhoranca në qytet të Shqipërisë, duke i cilësuar si njerëz të lidhur me krimin. "Si për të treguar botërisht se nga një vesh i kanë hyrë dhe nga tjetri i kanë dalë akuzat dhe alarmi ndërkombehtar për shndërrimin e Kuvendit të Shqipërisë në strehën më të padëgjuar në botë të narkotrafikantëve, tutorëve të prostitucionit dhe vrasësve, si për provuar se përpara paktit që ka bërë me botën e errët të krimit nuk ia ndjen as për Uashingtonin, as për Bruskelin, as për opozitën dhe as për opinionin publik, Edi Rama ka aktuar si kandidat për kryetar bashkie në bashkinë e kryeqendrës së krenarisë sonë kombëtare, në Krujë e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, Artur Bushin, i arrestuar në Itali në vitin 2010 si pjesëtar i një bande që trafikonte drogë nga Italia në Hollandë. Nuk skuqet, as nxihet Edi Rama tek ka vënë në lëvizje makinerinë e tij të shpifjeve dhe spekulimeve për t'i bërë pis të gjithë, që të mos i duket pislleku i tij, për të futur në një thes dyshime dhe akuzat që pakrahasueshme që kanë për qëllim të relativizojnë, justifikojnë dhe rehabilitojnë krimet e rënda, që janë subjekt i dekriminalizimit. "Shkolla" e trafikëve vazhdon të jetë shkolla e preferuar e partisë së Edi Ramës. Nga kjo "shkollë" ka ardhur Bushi

i Krujës, Roshi i Kavajës, dhjetëra e qindra të tjerë që i kemi denoncuar e do të vijojmë t'i denoncojmë publikisht në vijimësi. Është e mundur sepse Bushët dhe Roshët janë vetë Rama. Është e mundur sepse Bushët dhe Roshët janë kupola e vërtetë e Partisë Socialiste", deklaroi kreu Basha. Sipas Bashës, qëndrimi në kokë i çdo vote gjatë fushatës dhe ditën e votimit shpalolet si prioriteti i opozitës krahas platformës së qeverisjes vendore prej kandidatëve të saj. Në këtë linjë vjen paralajmërimi i kreut të opozitës. "Dua t'i paralajmëroj sot në emër të Partisë Demokratike, të opozitës, të qytetarëve të lirë të mbarë vendit: Ju keni rënë qafë ku nuk mban më shqiptarëve. Jua keni lidhur lakun e varfërisë në fyt. I keni gënjer sa ju ka dashur qejfi, ua keni mbushur zemrat me dhimbje e dëshpërim me arrogancën dhe papërgjegjshmërinë tuaj ekstreme. I keni poshtëruar me ujdite tuaja të ndyra me krimin, jeni në borxh të madh para shqiptarëve, por mos t'u shkojë mendja t'u prekni zgjedhjet e lira dhe demokraci, mos t'u shkojë mendja t'u prekni votën, t'u prekni gjykimin e lirë, pasurinë më të madhe të popullit sovran në demokraci. Mos provoni të vidhni e blini votat se ju pret fundi më i keq. Ne jemi e do të jemi në këmbë. Do ta fitojmë betejën e dekriminalizimit. Do ta fitojmë me popullin shqiptar, me zgjedhësit shqiptarë. Aleanca jonë me qytetarët është aleanca jonë për dekriminalizimin, për ndalimin e rënies, për nisjen e re, për ringritjen. Zgjedhësit

shqiptarë do të flakin me votë të lirë, me guxim dhe vendosmëri, ofertën e krimit të organizuar, kandidatët e krimit të organizuar, pushtetin e krimit të organizuar. Shqipëria është e qytetarëve dhe do të mbetet e qytetarëve, u shpreh Lulzim Basha. Për herë të parë kryetari i opozitës u ndal gjatë tek largimi masiv i shqiptarëve drejt vendeve të BE-së, tek e sheh këtë si pasojë e qeverisjes të pas 23 qershorit që nuk solli punë dhe mirëqenie. "Qytetarët në hall dhe në vështirësi nga gjithë Shqipëria i kanë kërkuar qeverisë të reflektojë ose të ikë, nga sytë këmbët. Për fat të keq, ata që po ikin nuk janë qeveritarët, por qytetarët. Eksodi masiv i shqiptarëve, nga Veriu në Jug, është lajmi më i trishtë që po dëgjojmë këto ditë. Është shenja e dorëzimit para skamjes e varfërisë, është dëshpërimi i mijëra familjeve që nuk mundën më. Shumë prej tyre i kemi parë të flasin kur thonë "po ikim se nuk kemi bukën e gojës". "Po ikim se nuk jetojmë dot më në këtë gjendje". Sipas statistikave zyrtare, Shqipëria vjen pas Sirisë, e cila është në gjendje të vazhdueshme luftime, për numrin e atyre që braktisin vendin. Prindër, fëmijë, të rinj, burra e gra që nisen drejt Europës, pa pasur një projekt të sigurt se ku po shkojnë dhe duke e ditur që nuk ka azil. Kaq e pamundur është bërë jeta për ta, kaq shumë ka humbur besimi, sa bashkëqytetarët tanë nisen gjithsesi. Është si arratisje nga ferri, një ikje për t'i shpëtuar skamjes, varfërisë, papunësisë. Ky është realiteti dramatik që e

gjen sot në Kukës, në Rrogozhinë, në Orikum, në Vlorë, në Korçë, Dibër, Lezhë, Elbasan, Shkodër e kudo. Ky është realiteti i krijuar drejtpërdrejt nga Edi Rama dhe Ilir Meta me politikën e tyre të dhunës dhe shtrëngimit, të rritjes së taksave, të tarifave, të çmimit të energjisë, të çdo produkti të konsumit. Është arratisje nga pasiguria, nga krimi që është ngritur në sistem. Këto janë pasojat e politikës së mbrapshtë të Rama-Metës, që ka çuar në humbjen e mijëra vendeve të punës, në rruhdhje, ikje dhe mbyllje të qindra bizneseve. Përpara se të nisë eksodi i njerëzve, ka nisur eksodi i biznesit, i kapitalit, i sipërmarrjes, i parasë. Kur ikën kapitali e paraaja, të dëbuar nga qeveria me arbitraritetin e me taksat e saj të rritura, atëherë ka varfëri, papunësi. Eksodi i varfërisë dhe dëshpërimit ka tronditur të madh e të vogël, mbarë Europën. E ka kthyer Shqipërinë në një kamp të madh të skamjes, papunësisë e korrupsionit qeveritar, dhe kjo i detyron qytetarët tanë të ikin. Këta janë të dëbuarit e Edi Ramës i cili, nuk po gjen asnjë moment të thotë një fjalë për këtë zhvillim dramatik", tha Basha. Në përfundim të deklaratës së vet, kreu i të djathtëve, Lulzim Basha ka përcjellë një mesazh për të gjithë ata që po shqyrtojnë mundësinë e largimit nga vendi është se jo azili, por bashkimi kundër mazhorancës i votës së 21 qershorit është zgjidhja. "Kam sot një thirrje për bashkëqytetarët tanë që po largohen. E di shumë mirë se kushtet janë ekstremisht të vështira, e di se keni fëmijë për të rritur e frymë për të mbajtur. Por nuk është ikja zgjidhja e problemeve. Bashkimi European e ka bërë të qartë se nuk lëshon azil për qytetarët e vendit tonë. Nuk vjen zgjidhja nga ikja dhe dëshpërimi. Zgjidhja vjen vetëm nga bashkimi, nga ngritja e zërit, nga këmbëngulja në kërkesat e drejta ekonomike dhe sociale. Shpëtimi vjen nga vota e 21 qershorit, që të largojmë të keqen që i ka zënë frymën vendit, që i ka hequr shpresat familjeve. T'i largojmë me një votë masive, të bashkohemi në këtë që është kthyer në detyrë kombëtare, për t'i hapur rrugën punësimit, taksave të ulëta, çmimit të ulët të energjisë, zhvillimit, krijimit të vendeve të punës. Të krijojmë një rend të ri demokratik, ku qytetarët dhe qeveria janë bashkë, ndajnë e vendosin bashkë, punojnë dhe ndërtojnë bashkë një ekonomi të fortë dhe të ardhme të sigurt, punë dhe dinjitet për të gjithë", deklaroi më tej Basha.

70 vjetori i gjyqit special/ Kolaboracionist apo patriot?

Nga Reshat Kripa

Në 70 vjetorin e gjyqit special natyrshëm të lind pyetja: Çfarë kanë qenë personazhet që aktivizoheshin në administratën shtetërore në periudhën e Luftës së Dytë Botërore, kolaboracionist apo patriot? Kjo pyetje qëndron pezull në skakierën e politikës shqiptare. Mendimet janë të ndryshme dhe shpesh herë përplasen midis tyre. Historianët e periudhës totalitare i rendisin politikanët që morën pjesë në administratën shtetërore të kohës në radhën e kolaboracionistëve. Madje, për këtë shkak, shumë prej këtyre politikanëve, si pjesëtarët e grupit të gjyqit special, me vendosjen e pushtetit komunist, shkuan në satër pa as më të voglin hezitim. Të tjerët ishin detyruar, për të mos pësuar të njëjtin fat, të merrnin rrugën e emigrimit në vendet perëndimore ku gjetën një strehë të sigurtë dhe një liri veprimi, ku asnjë organ shtetëror i këtyre vendeve nuk i radhiti në radhët e kolaboracionistëve. Pas ndryshimeve demokratike lindi edhe nje kategori tjetër historianësh që ngjarjet e asaj periudhe i shikonin me një sy tjetër. Kjo kategori ngulte këmbë, me të drejtë, se ngjarjet historike nuk duheshin parë bardhë e zi. Ylberi ka shtatë ngjyra dhe të gjitha ato duhen patur parasysh. Ndaj çdo gjë duhet parë në prizmin e

periudhës kur ka ndodhur. Personalisht, në periudhën e Luftës së Dytë Botërore, kam qenë mjaft i vogël për të kuptuar të vërtetën. Hera-herës dëgjoja tim atë kur bisedonte me miqtë e tij të ngushtë, opinione mbi figurat kryesore të luftës. Vija re se opinionet e tim eti binin ndesh me ato që na mësonte historia që bënim në shkollë. Por pata fatin që u arrestova. Them pata fatin se, gjatë kësaj kohe, mësova se Shqipëria kishte edhe një histori tjetër, ndryshe nga ajo që kisha mësuar në shkollë. Këtë histori ma mësuam ata burra të rrallë që zor se mund t'i vijmë më këtij kombi. Ata ishin doktor Isuf Hysenbegasi, Avokatët Xhevdet Kapshtica, Fatosh Kokoshi dhe Haki Karapici, kleriku Padre Mëshkalla dhe përkthyesi Gjon Shllaku, agronomët Meçan Hoxha dhe Sami Bitincka, mësuesit Tahir Hoxha dhe Matish Çefa dhe plot të tjerë që nuk po i përmend pasi do të duheshin faqe të tëra. Këta burra më flisnin për ngjarjet dhe personazhet kryesorë që ishin ndeshur gjatë periudhës së luftës me njëri-tjetrin. Më flisnin për ata që kishin pranuar të merrnin pjesë në administratën e lartë të pushtetit, për shkaqet pse kishin pranuar dhe nëse kishin vepruar drejt apo jo. Më flisnin edhe për aktivitetin e tyre në të kaluarën, për luftën e gjatë dhe përkushtimin e tyre në dobi të vendit. Në sytë e mi gjithmonë e më shumë lartësoheshin figurat

e këtyre martirëve të shquar që u sakrifkuan për Shqipërinë. Kështu tek unë u formua një opinion i plotë mbi aktivitetin e zhvilluar prej tyre ndër vite. Kohët e fundit, me zhvillimin e madh që ka marrë interneti, shfletoj faqet e tij dhe lexoj mbi këta burra. Çuditërisht ato përputhen me opinionin e krijuar prej meje qysh prej vitesh. Do përqendrohem vetëm në dy prej tyre, njëra nga e djathta dhe tjetra nga e majta
1. Patër Anton Harapi: 1921-1924, drejtues i revistës "Ora e Maleve". 1924, përkrah opozitës shqiptare me në krye Nolin, Gurakuqin, Fishtën e të tjerë. 1920-1930, ideator i organizimit politik të demokristianëve shqiptarë dhe përpjekjet për krijimin e një partie të këtyre parimeve. 1930-1936, Drejtor i revistës "Hylli i Dritës". 13 shtator 1943, anëtar i Këshillit të Lartë të regjencës. Pjesëmarrës i marrëveshjes me komandën gjermane që i konsideronte hebrenjtë qytetarë shqiptarë, si rezultat i së cilës asnjë hebre nuk iu dorëzua gjermanëve. Lidhur me këtë ai i tha ushtarakut të lartë gjerman: Marrëveshja është që trupat gjermane do ta përdorin territorin shqiptar vetëm si urë kalimi për në Greqi, pa i cënuar dhe pa ndërhyrë në çështjet e brendshme shqiptare. Më 1945 Arrestohet dhe dënohet me pushkatim. Në sallën e gjyqit i deklaroi gjykatësve: E pranova detyrën se nuk

mujsh me pamun Shqypninë të pushtueme prej anarkije, nuk dojshem të krijohet një babiloni shqyptare me luftë vllavrasëse qi zhatërronte katundet, familjet. Ndjeva mëshirë si për popull e gjithashtu edhe për Shqypni. Qeshë i shtrënguem të zgjedh njerën dysh: a të baj një marri tue e pranue këte detyrë, a të tregoj një dobësi tue u largue. Vendosa ma mirë të baj një marri ose, sikurse thonë ata shqyptarë qi duen të ruhen të pastër, desha të kompromentohem!" Ky ishte Patër Anton Harapi
2. Emrush Myftari Një i ri komunist kosovar, pjesëmarrës i luftës së Spanjës përkrah brigadave internacionale, shokë me Xhemal Kadën, Petro Markon, Skënder Luarasin. Më 17 prill 1941 Jugosllavia kapitulloi përpara ofensivës gjermane. Emrushi së bashku me një grup shumë të madh pejanësh pret ardhjen e çlirimtarëve gjermanë, siç i quante ai, ndërsa një grup serbësh ishin ngujuar në bashkinë e qytetit për ta pritur "okupatorin" me armë. Me mbërritjen e tanksit të parë gjerman, Emrushi hipën në tanks dhe së bashku me turmën e madhe i drejtohen vendit ku ishin serbët. Fillon përplasja. Nga ana kosovare vriten dymbëdhjetë trima. Së fundi serbët detyrohen të dorëzohen. Për këtë veprim, Emrushi u dënua me vdekje nga komunistët, vendim që mundi të zbatohet në vitin 1945. Si duhet

t'i quajmë veprimet e këtyre herojve, kolaboracionizëm apo patriotizëm? Ata i thirri zëri i atdheut pasi ishin pikërisht gjermanët që kishin krijuar Shqipërinë Etnike të ëndërruar prej shekujsh. Ishte Gjermania që kishte korriguar një gabim të pafalshëm të kryer nga Franca dhe Anglia në Konferencën e Londrës. Ishte së fundi Gjermania që e trajtoi vendin tonë jo si një vend të pushtuar por si një vend të lirë. Dhe ishin pikërisht komunistët ata që, duke mohuar vlerat kombëtare, ia kthyen sërish këto krahina jugosllavisë, armike e betuar e popullit tonë. Në të njëjtat kondita kishin luftuar dikur paraardhësit e tyre. A nuk ishin Ismail Qemali, Abdyl dhe Sami Frashëri, Vaso Pashë Skodrani dhe të tjerë, funksionarë të perandorisë turke? Por kjo nuk i pengoi të luftonin edhe për mëmën Shqipëri. Atëhere përse këta quhen patriot dhe intelektualët tanë kolaboracionista? Një miku im më thoshte një ditë: Bota baltën e bën njeri, kurse shqiptarët, për fat të keq, njeriun e kthejnë në baltë. Nuk doja t'i besoja sentencës së mikut tim, por ngjarjet e kohëve të fundit e vënë në dyshim ndërgjegjen time. E lë në ndërgjegjen tuaj, të nderuar pjesëmarrës, të gjykoni mbi drejtësinë e mendimeve të mia të shprehura në këtë shkrim. Do të mirëprisja çdo mendim hapur dhe pa prapaska, madje edhe ato kundra, që do të më paraqiteshin. Unë jam në pritje.

Në 70 vjetorin e përmbytjes së Shqipërisë

A kanë ideal komunistët?

Nga Fritz Radovani

-HAPNI DOSJET ! Aty keni me gjetë edhe "idealin" e këtyne dy miqëve! -Kur shkoi në Francë për studime Enver Hoxha deklaroi: "Unë do bëhem terrorist!..." Ky ishte "ideali" i tij, që iu plotsue dhe u realizue mbi 500.000 viktima Shqiptarësh nga viti 1941 e deri 1985, kur drejtoi PKSh (PPSh), terror të cilin, e vazhdoi Ramiz Alia, derisa mbylli sytë tue i sherbye shovenistëve sllavë, sovjetikë, kinezë, arabë e antishqiptarë... -E bija e Stalinit deklaroi në 1989 se: "Baba im Stalini, ishte vrasës i miliona rusëve..." E bija e Enverit deklaroi në 1991 se: "U zgjuan kafshët..." -Enver Hoxha deklaroi në 1967 se: "Shqipëria është shtet ateist.." dhe, në 1984 boton: në librin "Shenime për Lindjen e Mesme": "Shqiptarët duhet t'i referohen Kur'anit..." -Ramiz Alia në vitin 1970 nderton në Shkoder "Muzeun Ateist" i vetmi në Botë... dhe mbasi

vrasin, masakrojnë e burgosin me Enverin dhe Nexhmijen 138 Klerikë Katolik... Me 2 Dhjetor 1992, dy presidentët anadollakë, Ramiz Alia dhe Sali Berisha shpallin: "Republika e Shqipërisë antare e Konferencës Islamike"... Nexhmia zemrohet...e heshtë: "Nuk duhet të zemrohemi, për ideal të partisë, né jemi vëllezër gjaku me turqit..." -Në vitin 1990 kur Rinia Shkodrane kerkon heqjen e diktatorëve Stalin dhe Enver, asht ky Ramiz Ali terroristi barbar, që lanë me gjak piramidat kufitare dhe Shkodren heroike me Gjakun e Dëshmorëve të 2 Prillit 1991, Arben Broci me shokë. -Gjaku i paster i Rinisë Shqiptare ishte "ideali" i komunistëve tradhëtarë e terroristë! Ky ishte dhe asht "ideali" i trashigimtarëve të tyne atëherë dhe sot! A kerkoni fakte? HAPNI DOSJET! -Ja fjalimi i terroristit Ramiz Alia, në Byronë Politike të K.Q. të PPSH, në vitin 1989:

Shokë, pushteti ka qenë dhe do mbetet yni! Strategjia e ndryshimit... "Partitë dhe të tjerët që do të vijnë të kontrollohen nga ne. Sali Berisha, Fatos Nano dhe pasuesit janë dhe do të mbetën veglat tona besnike... -Si do ta përjetësojmë komunizmin? - "Të jeni të sigurtë që e ardhmja do të jetë jona. Kurrë nuk do të lejojmë restaurimin e pushtetit politik të armiqve tanë! Sistemi ynë tanimë është drejt kapitalizimit përballë sistemit kapitalist. Kështu na lind si detyrë që të ndryshojmë strategjinë tonë. Ndryshimet do të jenë në dy drejtime kryesore: në krijimin e pluralizmit politik dhe në respektimin e të drejtave të njeriut. Me këto të fundit edhe mund të abuzohet, pasi të drejtat janë gjëra që rregullohen brenda për brenda me ligj, por pluralizmi duhet të vendoset patjetër. Le të krijojnë kundërshtarët tanë parti të djathta, të majta apo të qendrës, madje do t'i nxisim dhe ne

vetë, por kryesore është që të gjitha këto parti të kontrollohen nga ne vetë. Për këtë, edhe programet e themelimit duhet t'i formulojmë ne. Për drejtimin e këtyre partive duhet të gjenden njerëz që të përkrahin strategjinë tonë. Partia që do të marrë pushtetin, jo vetëm që është e lirë të shajë pushtetin, por këtë ta bëjë fort, sepse kështu do të fitojmë simpatinë e Perëndimit dhe të disidencës antikomuniste. Dhe e dini pse?! Sikurse sapo të marrin fuqinë, do të fillojnë të hakmerren... Në zbatim të drejtave të njeriut, duhet t'u japim kompensimin në para, të burgosurit politikë t'i kompletojmë me komoditetet banimi. Të sekuestruarve dhe të shpronësuarve do t'u japim nga një letër në dorë që t'u njihet prona, por prona vetëm në pak duar do të bjerë, pasi ligji do t'i ngatërrojë njëri me tjetrin... Kësaj kategorie mendoj që t'i japim pasaportë për t'u larguar nga Shqipëria më mirë dhe me kaq do të jenë të kënaqur. Pasuria e tyre na përket neve,

sëpse ne e bëmë. -Gorbaçovi më dërgoi disa dokumente e plane dhe po i studioj prej kohësh...Kjo është një mbledhje vetëm për ne më të besuarit, ndaj le të flasim hapur. Ne kemi kuadro sa për shtatë Komitetet Qendrore, pra frika nuk duhet të ekzistojë. Shumë intelektualë do të na kundërshtojnë, por me ta do të rregullohem duke u dhënë punë e ngritur paksa rrogën. Problem mund të jenë intelektualët pensionistë. Këtyre do t'u ofrojmë krijimin e Shoqatës së Veteranëve të Luftës dhe të Punës... -Kosova është në pragun e shpalljes së Kushtetutës. Është punë e tyre, ne e kemi programin dhe platformën tonë. Strategjia është e qartë dhe kemi përcaktuar rrugët për zbatimin e qëllimit misionit tonë. Nën një propagandë ekstreme kundër komunizmit dhe me disa ndëshkime të vogla, sa për sy e faqe ndaj nomenklaturës së lartë komuniste.

Jezusi i Nazaretit

Joseph Ratzinger
Benedikti
XVI

Jezusi i
Nazaretit

55

Shtëpia Botuese "55"

Në këtë libër, Papa Benedikti i XVI i vendos ngjarjet në shtatë ditët më të rëndësishme të fesë së krishterë, me hyrjen e Jezusit në Jerusalem deri në ringjalljen e tij. Qëllimi i Papës në këtë libër është që ta sjell lexuesin dhe besimtarin më afër Jezusit, të zbehur nga shkëputja mes "Jezusit historik" dhe "Jezusit të Besimit". Libri fillon pikërisht me hyrjen e Jezusit në Jerusalem si "mbret i paqes". Ai nuk vjen si revolucionar politik, nuk mbështetet në dhunë, pasi dhuna është "vegël e preferuar e antikrishtit.



Gjykata Kushtetuese i hap rrugën themelimit të Gjykatës Speciale

Gjykata Kushtetuese e Kosovës shpall të pranueshme kërkesën e kryetarit të Parlamentit të Kosovës, një vendim sipas të cilit Amendamenti nr.24 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës nuk pakëson të drejtat dhe liritë e njeriut, të përcaktuara në Kapitullin II dhe III të Kushtetutës, ndryshim i cili ka të bëjë me formimin e Gjykatës Speciale për Krime të Luftës.

Në arsyetimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës theksohet se Gjykata, në mbështetje të nenit 113.9 dhe të nenit 144.3 të Kushtetutës, në mbështetje të nenit 20 të Ligjit dhe në mbështetje të rregullit 56 (1) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në seancën e mbajtur më 14 prill 2015, njëzëri vendos të deklarojë të pranueshme kërkesën e kryetarit të Parlamentit, të dorëzuar më 9 mars 2015, me Amendamentin nr. 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: "Gjykata Kushtetuese e Kosovës konfirmon që Amendamenti nr. 24 nuk pakëson të drejtat dhe liritë e njeriut, të përcaktuara në Kapitullin III të Kushtetutës dhe me shkronjën e me frymën e saj, siç është përcaktuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës; Dhe, fton të t'ua kumtoj këtë aktgjykim palëve dhe ta publikojë atë në Gazetën Zyrtare," theksohet në aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Pas miratimit nga Gjykata Kushtetuese, tani pritet që Parlamenti i Kosovës t'i nisë procedurat për amendimin e Kushtetutës së Kosovës, me anë të një votimi të dyfishtë për themelimin e Gjykatës Speciale për Krime të Luftës. Nëse këto amandamente kalojnë, atëherë pritet që të miratohet edhe ligji për themelimin e dhomave të veçanta të prokurorisë dhe gjykatave, të cilat do të udhëhiqen nga ndërkombëtarët dhe do të trajtojnë raste të supozuara të krimeve të luftës, në bazë të një hetimi të prokurorit amerikan Clint Eilliamson. Hetimet e prokurorit Eilliamson, mbështeten në raportin e



SHBA dhe BE mirëpresin vendimin e Gjykatës Kushtetuese

Ambasada e SHBA-ve dhe Zyra e Bashkimit Evropian mirëpresin vendimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me amandamentet e propozuara për Gjykatën Speciale.

"Ky vendim ndihmon që t'i hapet rruga Parlamentit për të krijuar Gjykatën Speciale, zotim ky që Kosova e bëri në Shkëmbimin e Letrave me Përfaqësuesen e Lartë të BE-së në vitin 2014. Për Kosovën është me rëndësi që të merret me akuzat e bëra në Raportin e Këshillit të Evropës të vitit 2011 ashtu që Kosova të shkojë përpara dhe të tregojë përkushtimin e saj të vazhdueshëm ndaj sundimit të ligjit", thekson Ambasada e SHBA në Prishtinë duke shprehur mirëkuptimin se për disa ky është një vendim i vështirë por kjo ka të bëjë me individët dhe jo me luftën e Kosovës për çlirim. "SHBA mbesin në përkrahje të punës që Task Forca Hetuese Speciale ka bërë duke u marrë me këto akuzat në mënyrë kredibile, dhe i bën thirrje Parlamentit të Kosovës që të bëjë hapat e ardhshëm për të themeluar Gjykatën Speciale", thekson Ambasada e SHBA. Ndërkohë zyra e BE në Kosovë duke mirëpritur vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me formimin e Gjykatës Speciale inkurajon të gjithë aktorët e përfshirë që ta trajtojnë themelimin e Dhomave të Specializuara si prioritet në interesin e Kosovës. "Është e rëndësishme që Kosova të ndjek angazhimin e vet të miratuar nga Parlamenti i Kosovës në prill të vitit 2014, dhe të vazhdojë përpjekjet për t'i themeluar Dhomat e Specializuara", thekson përfaqësuesi special i BE-së, Samuel Zhbogar duke shtuar se sigurimi i një mjedisi të qetë ku mund të mbahet një proces gjyqësor i pavarur dhe i paanshëm është e vetmja mënyrë për t'i adresuar akuzat serioze. "Dhomat e Specializuara nuk do ta rishkruejnë historinë as nuk do ta gjykojnë atë, por do të kërkojnë të përcaktojnë drejtësi dhe përgjegjësi për çfarëdo vepra penale individuale."

zvicernit Dick Marty, të prezantuar në Këshillin e Evropës mbi pretendimet e tij për "trafikim organesh të serbëve nga disa ish-pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës".

Ndryshe, me shumicë votash Parlamenti i Kosovës ratifikoi me 23.04 2014 marrëveshjen Kosovë-Bashkim Evropian, e cila mundëson themelimin e Gjykatës

Speciale të Kosovës dhe vazhdimin e mandatit të ristrukturuar të misionit EULEX deri në qershor të vitit 2016. Për këtë të fundit do të duhet amendimi i disa ligjeve të Parlamentit të Kosovës. 89 deputetë votuan pro themelimit të Gjykatës Speciale, ndërsa 22 votuan kundër.

Të gjitha subjektet politike të përfaqësuara në Parlamentin e

Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese pritet që Parlamenti i Kosovës t'i nisë procedurat për amendimin e Kushtetutës së Kosovës, me anë të një votimi të dyfishtë për themelimin e Gjykatës Speciale për Krime të Luftës. Vendimi u përshëndet nga SHBA dhe BE

HAPËSIRË SHQIPTARE



Beograd – "Mendoj se Hashim Thaçi nuk ka se pse vjen në Beograd". Kështu u shpreh shefi i diplomacisë serbe, Ivica Dačić pas paralajmërimeve të mediave se ministri i punëve të jashtme të Kosovës do të marr pjesë në një takim të organizuar nga organizata joqeveritare "Ambasadoret e paqes" ku do të merrnin pjesë katër ministra të jashtëm të rajonit ndërsa shtoi se takimin nuk e organizon qeveria e Serbisë dhe as ai unë nuk e kishte në plan të marr pjesë në këtë takim. I pyetur nëse policia serbe do të garantoj siguri Thaçit nëse ai vjen, ai u shpreh: "Nuk mendoni seriozisht se ai vërtetë do të vij pa marrëveshje me qeverinë serbe"? theksoi Dačić duke e pranuar me këtë rast se për çdo vizitë të zyrtarëve serbë në Kosovë merret leja nga Prishtina zyrtare. Ndryshe, mediat kosovare duke ju referuar atyre serbe, përveç paralajmërimit të vizitës së Thaçit më 24 Prill në Beograd, theksojnë se për këtë vizitë do të mobilizohen 4.000 policë.



Shkup - Ish kryeministri i Maqedonisë, Lubčo Georgievski e ka përkrahë idenë që kryeministri i një qeverie teknike që do të formohet për tejkalim të situatës aktuale në Maqedoni, të jetë shqiptar. Gjatë debatit të organizuar nga QMBI, Georgievski ka vlerësuar se shqiptarët e Maqedonisë kanë së paku 4-5 intelektualë të kalibrit të lartë, që mund të ushtrorjnë këtë detyrë. "Kur jemi tek qeveria e ekspertëve u promovua ideja se më mirë do të ishte që në këtë moment një shqiptar të jetë kryeministër i qeverisë teknike. Mua personalisht nuk më pengon kjo dhe vlerësoj se shqiptarët në vitet e fundit kanë nxjerr 4-5 intelektualë që mund të kryejnë me sukses këtë detyrë në Maqedoni", tha Georgievski duke shtuar se do të ishte mirë që partitë kryesore ta mandatojnë qeverinë eventuale teknike që të zhvillojë negociatën me direkte për tejkalimin e problemeve që po pengojnë integrimin e Maqedonisë, para së gjithash problemi për emrin me Greqinë dhe problemi me Bullgarinë. Georgievski poashtu ka propozuar që në funksion të tejkalimit të krizës, të propozohet amnistim i personave që kanë bërë përgjimet, me qëllim që e vërteta rreth kësaj afere të dalë në shesh.



Prishtinë - EULEX-i me të vërtetë ishte EUL - Experiment. Kështu u shpreh shefi i këtij misioni në Kosovë, Gabriello Meucci në emisionin "Rubikon" në KTV-së, duke pranuar se mandati i EULEX-it do të përmbillet. Meucci, i cili tha se ka ardhur në Kosovë për ta dërguar drejt mbylljes mandatin e EULEX-it, është shprehur se në fillim e ka pasur të vështirë t'i kuptojë akuzat ndaj misionit që po udhëheq. "Por, nëse ka qenë apo jo i suksesshëm eksperimenti i BE-së në Kosovë, kjo do të shihet më pas dhe këtë do ta vlerësojnë historianët", tha Meucci duke shtuar se megjithatë Kosova nuk qëndron keq sa i përket korrupsionit, pasi sipas tij, është e 8-ta në rajon sa i përket kësaj dukurie. Ndërkohë, Ilir Deda ka shprehur frikën e tij se pas përfundimit të mandatit të EULEX-it.

Kosovës, me përjashtim të lëvizjes Vetvendosja, votuan në favor të themelimit të Gjykatës Speciale, ndonëse pothuaj të gjithë thanë se janë në presion nga bashkësia ndërkombëtare dhe janë para një fakti të kryer. Ose Parlamenti i Kosovës ta votojë themelimin e Gjykatës Speciale, ose këtë do ta bëjë Këshilli i Sigurimit i OKB-së

Jahjaga kërkon konsensus

Pasi ka pranuar aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese rreth amendamenteve kushtetuese për krijimin e Gjykatës Speciale, Presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga tha se me këtë aktgjykim është bërë një hap drejt përbushjes së obligimeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, në respektim të plotë të frymës së Kushtetutës së vendit dhe ligjeve të tij. "Veprimi i ardhshëm është përmblyllja sa më e shpejtë e diskutimeve rreth ligjit që rregullon gjykatën dhe që mundëson përgatitjen e pakos legislative, e cila do të votohet në Parlament", tha Presidentja Jahjaga duke bërë thirrje për një konsensus të përgjithshëm politik dhe shoqëror për përbushjen e kësaj marrëveshjeje ndërkombëtare përmes krijimit të bazës ligjore për Gjykatën e cila do të adresojë akuzat e dalura nga raporti i Këshillit të Evropës dhe që assesi nuk do të gjykojë përpjekjet tona për çlirim dhe pavarësi. "Kosova duhet ta demonstrojë përkushtimin e saj për të përmblyllur këtë kapitull të rëndë", përfundon Presidentja Jahjaga e cila udhëheq koordinimin ndërinstitucional për themelimin e Gjykatës Speciale në përputhje me marrëveshjen e aprovuar nga Parlamenti i Kosovës vitin e kaluar. Ndërkohë kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa u ka thënë zyrtarëve të BE-së se miratimi i pakos ligjore për Gjykatën do të ndodh në muajin maj. E, funksionalizimi i kësaj gjykate nuk pritet të ndodh para fundit të këtij viti, pasi pritet të ketë konkurs për gjyqtarë e prokurorë që do të merren me rastet e krimeve të luftës.

Tregu bioenergjetikë në Shqipëri ende në fillesat e tij

Prezantohet Strategjia e Peshkimit

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë së qytetit të Durrësit në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë së Rajonit të Puljas në Itali, zhvilluan të mërkurën një seminar për bioenergjinë. Qëllimi është njohja e fermerëve me mundësitë që ofron prodhimi i energjisë nga biomasa pyjore dhe mbetjet bujqësore në karburant. Kryetari i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Durrësit, Andrea Xhavera theksoi në fjalën e tij se, ky treg në vendin tonë është ende në fillesat e tij. Shqipëria është bërë pjesë e projektit "ELISAA" për zhvillimin e bioenergjisë që nga viti 2012. Trajnimi është konceptuar në formë kursit në rrjetin elektronik. Pjesë e këtij projekti janë vende si Austria, Polonia dhe Italia. Edhe pse tregu i biokarburanteve në këto

vende njih një zhvillim të konsiderueshëm, shumë pak mund të thuhet për Shqipërinë, ku ky treg është inekzistent.

Strategjia e peshkimit

Strategjia e Peshkimit në Shqipëri, e përgatitur nga delegacioni i BE-së dhe ekspertë të bujqësisë, u prezantua dje në Tiranë. Ministri i Bujqësisë, Edmond Panariti tha se do të hidhen bazat për zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sektori, pasi është sfidë e qeverisë të zhvillojë këtë sektor në bazë të një strategjie të mirëkonsultuar me grupet e interesit përpara se të vihet në zbatim. "Një sektor nuk mund të zhvillohet pa u mbrojtur nga paligjshmëria, dhe ky është hapi i parë që kemi filluar ta hedhim, pasi jemi të vendosur të ndalojmë veprimtarinë kriminale, peshkimin me dinamit



dhe eksploziv", theksoi ministri Panariti.

Porti i Durrësit, gjatë 3-mujorit të parë u përpunuan 864 mijë ton mallra



Në kalatat e portit të Durrësit sot po përpunohen katër anije, me 8800 ton mallra dhe 470 kontenerë gjithsej. Ndërkaq, brenda ditës së enjte pritet të ankorohen në port edhe gjashtë anije të tjera, një prej të cilave ndodhet në radë. Burime nga dispeçeria portuale, bëjnë me dije se që nga orët e para të ditës së mërkurë në portin më të madh të vendit janë ankoruar dhe kanë nisur të shkarkohen anija "Vega epsilon" me 470 kontenerë, anija "Gulizar" me 3063 ton ure, anija "Amethyst" me 3033 ton grurë dhe anija "Thunder" me 2429 ton pllaka zdrukthi dhe hekur. Sipas të njëjtave burime, në kalatën 11 do të ankorohet pas

disa orësh anija "Maestro Eagle", që do të shkarkojë 10.999 ton qymyr. Sot priten në port anijet "Vega Aquila" dhe "MSC Jilhan", që do të shkarkojnë 263 kontenerë gjithsej. Në 24 orët e ardhshme do të fillojë edhe përpunimi i anijeve "Union", "Frosina" dhe "Angela", me përkatësisht 2462 ton llamarinë, 2500 ton çimento dhe 5082 ton kripë. Gjatë 3-mujorit të parë të këtij viti në kalatat e portit të Durrësit janë përpunuar afro 864 mijë ton mallra gjithsej, ose 12 për qind më shumë se sa në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Vëllimet e eksporteve dhe importeve të kësaj periudhe nëpërmjet portit më të madh të vendit kanë një diferencë shumë të vogël, prej 26 mijë ton.

Qiratë në Tiranë, shtohen kërkesat për vila

Në tregun imobiliar kanë filluar të shihen kërkesat për vila me qera. Kryesisht ato merren nga të huajt, apo biznese të ndryshme, pasi kanë ambiente të bollshme dhe këta qiramarrës kanë edhe mundësi të paguajnë qiranë e kripur. Vilat në përgjithësi kanë një çmim mbi një mijë euro. Apartamente me qira kërkohen kryesisht në zonat e ish-Bllokut, zona e Liqenit Artificial, ndërsa nga ata me buxhet të pakët kërkesat janë në periferi. Luis Pertena, agjent imobiliar tregon për AS trendin e fundit të këtij tregu. "Vilat kërkohen me qira po kryesisht janë të huajt që i kërkojnë. Po edhe vendasit, mund të kenë nevojë sidomos për banesa. Të huajt i kërkojnë kryesisht për zyra, trupa diplomatike, spitale private. Zakonisht janë të shumtë ata që janë kufitarët tanë, zakonisht italianët, që vijnë dhe kanë nevojë për qira, efekte pune dhe



shkollimin. Çmimet në përgjithësi ngrihen, nuk ulen, ndonjëherë shumë rrallë", thotë Luis Pertena, agjent imobiliar. Çmimi është ai që përcakton zgjedhjen e qytetarëve që kërkojnë banesa me qira, apo ambiente të tjera. Në qendër të qytetit ai vjen duke u rritur, dhe në periferi ofron mundësi për të gjitha ata me të ardhura të pakta. "Tirana e Re, zona rreth e përqark ish-bllokut dhe qendrës dhe afër Liqenit, kanë një farë kërkesë sidomos për klientët që kanë një farë buxheti dhe që kërkojnë

një farë qetësie dhe sigurie më shumë që qendra apo zona e Liqenit për ajrin e pastër dhe largesën nga zhurmat dhe kaosi i qytetit. Të gjitha varen nga çmimi, nga zonat që janë shumë të shtrenjta, zonat e Bllokut dhe qendrës, që fillojnë nga 300 euro deri në një mijë euro", vijon Pertena. Tregu imobiliar duket se nuk është ndikuar nga kriza, pasi çmimet e qerave pësojnë vetëm rritje. Tre mujori i parë i vitit 2015 ka rritur me 15 % çmimet, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Bashkia Kamëz, gjithëpërfshirje të investimeve në gjithë territorin e qytetit

Rruga "Marin Barleti" dhe rrjeti i KUN-së në lagjen nr. 6 Bathore, tjetër investim i tenderuar nga bashkia

Investimet e Bashkisë Kamëz për vitin 2015 përfshijnë të gjitha zonat dhe lagjet e qytetit, në mënyrë që të ndikojnë në përmirësimin e infrastrukturës, për pasojë edhe të kushteve të jetesës së çdo familjeje. Një prej investimeve që do të realizohen së shpejti, është edhe ndërtimi i rrugës "Marin Barleti" në lagjen nr. 6 Bathore, e cila është tenderuar, bashkë me rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura. Ky projekt është parashikuar të zbatohet me fondet

e miratuara në buxhetin e vitit 2015, pjesa më e madhe e të cilit shkon për investimet publike dhe shërbimet ndaj qytetarëve. Rruga "Marin Barleti" ndodhet në lagjen 6 Bathore. Ajo kufizohet me rrugën "Erzeni" dhe rrugën "Martin Camaj". Ndërtimi i kësaj rruge ka një rëndësi të madhe si ekonomike dhe sociale. Kjo, për shkak edhe të ndërtimit të rrjetit të KUN-së. Duke pasur parasysh që kjo zonë ka pasur probleme me KUN-në, linja e re që do të ndërtohet do ta lehtësojë

shkarkimin e ujërave të zonës, duke mos pasur përmbajtje të karakterit të mëparshëm. Për këtë projekt i hartuar nga ana e specialistëve të Bashkisë ka parametra që i përshtaten zhvillimit të vullshëm të zonës. Ndërkaq, ndërtimi i rrugës do të ndikojë në lehtësimin e lëvizjes së komunitetit, duke qenë se ky segment bën lidhjen e një zone që është shumë e populluar. Gjatësia e këtij segmenti është 226 ml, me gjerësi 4.2 ml dhe do të ketë kunetë dhe bordurë.



Vlera e investimit llogaritet për këtë vit nga 40-70 milionë euro

TAP nis në verë punimet për ndërtimin e rrugëve

Në fillim të verës pritet që projekti TAP të nisë nga puna, ku Shqipëria është vendi i parë ku do të nisnin punimet me përmirësimin dhe ndërtimin e rrugëve të kalimit dhe urave. Sipas burimeve, TAP do të ndërtojë dhe do të përmirësojë rreth 110 km rrugë, do të rikonstruktojë 50 ura ekzistuese dhe do të ndërtojë 2 ura të reja

Në fillim të verës pritet që projekti TAP të nisë nga puna, ku Shqipëria është vendi i parë ku do të nisnin punimet me përmirësimin dhe ndërtimin e rrugëve të kalimit dhe urave. Sipas burimeve, TAP do të ndërtojë dhe do të përmirësojë rreth 110 km rrugë, do të rikonstruktojë 50 ura ekzistuese dhe do të ndërtojë 2 ura të reja, ku vlera e investimit llogaritet për këtë vit nga 40-70 milionë euro. Sipas burimeve, TAP këto ditë ka përzgjedhur dy kompanitë fituese për ndërtimin dhe rehabilitimin e rrugëve dhe urave në Shqipëri: "Gener 2" sh.p.k dhe "Sicilsaldo" s.p.a pas një procesi të nisur me një proces para-kualifikimi në prill 2014, që vijoi me shqyrtimin e ofertave nga kompanitë, që

përmblushnin kriteret. "Gener 2" është kompani shqiptare ndërtimi me rreth 20 vjet eksperiencë me projekte të shumta si dhe për hartimin, menaxhimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e projekteve private dhe atyre shtetërore, financuar nga shteti. Ndërsa "Sicilsaldo" është kompani italiane e specializuar në fushën e inxhinierisë, prokurorimit dhe ndërtimit në fushën e naftës, gazit dhe në sektorin energjetik me shërbime që variojnë nga dizajni i strukturave, tek mirëmbajtja e impianteve dhe gazsjellësve. Projektet e parashikuara në kontratën me dy kompanitë kanë ndërtimin dhe rehabilitimin e mbi 100 kilometrave rrugë përgjatë shtegut të gazsjellësit nëpër trasenë

që nis nga Qarku Korçë në fshatrat Vishocicë, Trestenik, Vithkuq dhe Shtyllas, kalon në fshatin Kakrukë dhe rrethinat e Potomit në qarkun e Beratit dhe në Topojë të qarkut Fier. Ndërsa do të ndërtohen 2 të reja, pritet të rikonstruktohen rreth 50 ekzistuese në zonat e Korçës, Beratit dhe Fierit. Sipas burimeve nga TAP, në Shqipëri punimet e tubacionit do të prekin rreth 11.000 parcela toke. Marrëveshjet mes TAP dhe pronarëve dhe përdoruesve të tokave që preken, parashikojnë pagesat dhe kompensimet përkatëse para fillimit të punimeve. Puna për këtë proces ka nisur që në vitin 2013 dhe deri sot, sipas burimeve të TAP-it janë lidhur një numër shumë i lartë marrëveshjesh me pronarët e tokave që preken nga projekti.




Procesi i sigurimit të të drejtave mbi tokën po ecën sipas afateve dhe në përputhje me standardet e performancës së Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Pas punimeve me rrugët dhe urat, TAP do të nisë

ndërtimin e tubacionit, që do të nisë sipas planifikimit në vitin 2016. Projekti TAP (Gazsjellësi Trans Adriatik) po ecën sipas parashikimeve me qëllim, që sipas planit të jetë gati në vitin 2020, kohë kur do të nisë

prodhimi i gazit prej vendburimit Shah Deniz. Gjithashtu TAP pritet të mbështesë zhvillimin e Master-Planit për gazin shqiptar, çka do ta vendosë Shqipërinë në hartën ndërkombëtare të gazit.

Autoriteti i Konkurrencës ka zgjedhur prof. Servete Grudën, zëvendëskryetare të Komisionit të Konkurrencës. Sipas nenit 21 të ligjit të Konkurrencës, zëvendëskryetari zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve dhe sipas nenit 25 të ligjit zv.kryetari kryen funksionet e kryetarit në mungesë të këtij të fundit.



AK zgjedh Servete Grudën zëvendëskryetare të konkurrencës


Autoriteti i Konkurrencës ka zgjedhur prof. Servete Grudën, zëvendëskryetare të Komisionit të Konkurrencës. Sipas nenit 21 të ligjit të Konkurrencës, zëvendëskryetari zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve dhe sipas nenit 25 të ligjit zv.kryetari kryen funksionet e kryetarit në mungesë të këtij të fundit. Sipas vendimit nr. 347, datë 16.02.2015 të Komisionit

të Konkurrencës "Për zgjedhjen e Zëvendëskryetarit të Komisionit të Konkurrencës", znj. Gruda do të mbajë pozicionin e numrit 2 të Autoritetit i cili drejtohet prej më shumë se 8 vitesh nga Lindita Milo (Lati). Komisioni i Konkurrencës është organi vendimmarrës i Autoritetit dhe përbëhet nga pesë anëtarë. Ai vepron si një organ kolegjal i përhershëm.

Shtëpia Botuese "55"

Botimet e reja

"Kryeministrat dhe ministrat e shtetit shqiptar në 100 vjet"



Libri: "Kryeministrat dhe ministrat e shtetit shqiptar në 100 vjet", 273 faqe me ilustrime.

Autori: Kastriot Dervishi
Shtëpia Botuese "55",
Tiranë

"Kryeministrat dhe ministrat e shtetit shqiptar në 100 vjet" është një fjalor enciklopedik i veçantë që tregon të dhënat kryesore të 467 personave që kanë qenë kryeministra dhe anëtarë të Këshillit të Ministrave të shtetit shqiptar në këto 100 vite. Botimi me ilustrime është i pari i këtij lloji në Shqipëri. Libri është i ndarë në disa kapituj. Në fillim jepen të gjitha kabinetet shqiptare dhe një përmbledhje e programeve dhe historikut të tyre sipas epokave. Jepen jetëshkrimet me foto të personave që kanë qenë anëtarë të Këshillit të Ministrave, ndërsa statistika të tjera tregojnë të dhëna mbi ministrat. Një vend i posaçëm i është lënë fotografive ku kanë qenë selitë të Këshillit të Ministrave si dhe ministrive kryesore.

Botimet e reja

TRAGJEDIA DHE LAVDIA E KLERIT KATOLIK NË SHQIPËRI

Dr. PJETËR PEPA

T

TRAGJEDIA

DHE LAVDIA E KLERIT KATOLIK NË SHQIPËRI

55
Shtëpia
Botuese

VOLUMI I

Në këtë libër prej dy vëllimesh, Dr.Pjetër Pepa sjell dëshmi rrënqethëse të persekutimit që demoni i kuq politik, komunizmi, i bëri Kishës Katolike në Shqipëri. Janë me dhjetëra e qindra klerikë në mbarë vendin të persekutuar, dënuar, internuar dhe ekzekutuar.

Qytetarja lidh aktmarrëveshjen me OSHEE, 3 ditë më pas prokuroria kërkon ndjekje penale

Mbajtja për më shumë se 8 orë në ambientet e Komisarariatit Nr 3 në Tiranë të një nëne dhe vajzës së saj 4-vjeçare shkaktoi reagime të ndryshme për format e ndalimit të policisë



Mbajtja për më shumë se 8 orë në ambientet e Komisarariatit Nr.3 në Tiranë të një nëne dhe vajzës së saj 4-vjeçare shkaktoi reagime të ndryshme për format e ndalimit të policisë.

Por sot prokuroria kërkon ndjekjen penale të familjares, ndonëse ajo i është nënshtruar aktmarrëveshjes me OSHEE.

Këtë vajzë 4-vjeçare së bashku me prindin e mbajtën mbi 8 orë në ambientet e Komisarariatit Nr 3 në Tiranë. Asnjë masë nuk u mor ndaj uniformave blu të cilët kryen një krim edhe sipas Kryeministrit pavarësisht ngjyrave politike që i jepen një fakti. Por historia nuk ka mbaruar për nënën e të miturës të cilën kërkojnë ta ndëshkojnë me burg edhe pse i është nënshtruar kërkesave të OSHEE. Aktmarrëveshja

mban datën 24 shkurt të këtij viti, ku përcaktohet edhe shmangia e procedurës penale.

Vetëm 3 ditës pas lidhjes së aktmarrëveshjes, prokuroria kërkon procedim penal me akuzën e vjedhjes së energjisë elektrike. E rilidhi energjinë elektrike sepse vajza e saj është e sëmure dhe është e gatshme ta vërtetojë me ekspertizë mjekësore. I kërkuan të shlyente debinë prej 500 mijë lekësh, dhe prej tre muajsh zbaton akt marrëveshjen e lidhur me OSHEE.

Ndërsa kërkesës së saj iu përgjigjën me heshtje. Askush nuk u ndëshkua për mbajtjen e një të miture në ambientet e një komisaritati policie, përkundrazi sot kërkojnë ndëshkimin e nënës që denoncoi publikisht këtë formë ndalimi në kundërshtim me ligjin.



9 rregullat për t'u mbrojtur nga dielli

Dermatologia e njohur, Erjona Shehu, nëpërmjet një statusi në rrjetin social "Facebook" ka komunikuar 9 rregullat për t'u mbrojtur nga dielli, në prag të sezonit pranverë-verë 2015.

9 rregullat për t'u mbrojtur nga dielli:

1. Vendoseni përditë krem mbrojtës, minimumi 15 minuta para se të dilni nga shtëpia. Ideal është filtri mbrojtës SPF 30 dhe në etiketë duhet të shkruajë "broad spectrum" që do të thotë mbrojtje si nga rrezet UVA dhe nga ato UVB
2. Rivendoseni krem çdo dy orë, madje dhe më shpesh nëse jeni ende nën diell apo po djersini.
3. Mbani syze dielli me mbrojtje UVA.
4. Mbani kapele strehëgjera e me brima dhe T-shirt pambuku kur jeni në diell.
5. Shmangni qëndrimin në diell nga ora 10.09 deri në 16.00.
6. Bëni kontrolle të vazhdueshme të lëkurës para pasqyrës për të parë nëse keni rritje nishanesh apo ndryshime në lëkurë.
7. Nëse jeni prind merrni të njëjtat masa për fëmijën tuaj.
8. Zgjidhni produkte kozmetike që ofrojnë mbrojtje UVA.
9. Mos përdorni shtretër nxirës.



Ricertifikimi i mjekëve në 30 Prill



Të gjithë mjekët të cilët nuk kanë mundur të përmbushin detyrimet e programit të ricertifikimit, afati i fundit mbetet 30 prilli. Mbledhja e Bordit të Ricertifikimit Akreditimit të Profesionistëve të Shëndetësisë, nën drejtimin e Ministrit të Shëndetësisë Ilir Beqaj, diskutoi ditën e djeshme, çështjet e ankesave të profesionistëve që nuk kanë përmbushur detyrimet në edukimin e vazhdueshëm, rregulloren e provimit të ricertifikimit. Ndërkaq, në mbledhjen e Bordit u miratua rregullorja në të cilën u përjashtuan nga detyrimet e

programit të ricertifikimit të gjithë anëtarët e komisioneve të miratimit të titujve akademike dhe ekspertët e oponencës. Ndërkohë që në datën 10 Maj do të mund të hartohet lista përfundimtare e profesionistëve të shëndetësisë lidhur me përmbushjen e detyrimeve të programit të certifikimit. Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim, do të njoftojë urdhrat e profesionistëve të shëndetësisë, drejtuesit e institucioneve të sistemit të kujdesit shëndetësor lidhur me profesionistët e shëndetësisë që nuk kanë përmbushur detyrimet e programit të ricertifikimit.

IKMT rrëzoi objektet në Rotondon e Grabianit, avokati Totozani me banorët: Hetim për prishjet

Avokati i Popullit Igli Totazani nuk arriti të ndaloje fadromat e IKMT-se në Rrotonden e Grabianit në Lushnjë. Dy ndërtesa përkatësisht dy dhe tre kateshe u shemben dhe pse banoret kundërshtuan me

force. Totozani doli në mbrojtje të banoreve që po u prisheshin pronat, dhe u premtoi atyre se për këtë çështje do të hapeshin hetimet. IKMT ka nisur aksionin në Grabjan dhe Çerme para një

jave, por është përballur me rezistencën e familjeve që pretendojnë se pronat e tyre janë të ligjshme. Ata kërkonin fillimisht kompensimin, por IKMT vazhdoi aksionin e prishjeve.



Testimi i mësuesve, Avokati i Popullit: I paligjshëm

Testimi i mësuesve që është parashikuar të zhvillohet në muajin maj, nuk mbështet në ligj. Kjo deklaratë vjen nga institucioni i Avokatit të Popullit, ku nëpërmjet komisionerit Ermir Kapedani, është bërë publik qëndrimi i këtij institucioni, përpara deputetëve në komisionin parlamentar të edukimit



Testimi i mësuesve që është parashikuar të zhvillohet në muajin maj, nuk mbështet në ligj. Kjo deklaratë vjen nga institucioni i Avokatit të Popullit, ku nëpërmjet komisionerit Ermir Kapedani, është bërë publik qëndrimi i këtij institucioni, përpara deputetëve në komisionin parlamentar të edukimit. Sipas komisionerit, ligji i arsimit parauniversitar nuk e parashikon një nismë të tillë, ndërkohë që

profesioni i mësuesit funksionon sipas kriterëve ligjore të vendosura që prej 2009. "Ne si institucion i Avokatit të Popullit ndjekim zbatimin e ligjit, dhe ligji në këtë rast nuk lejon testimin e mësuesve. Mësuesi pasi merr diplomën përkatëse, ndjek praktikën profesionale dhe pastaj pasi merr provimin e shtetit sipas neneve të parashikuara, pikërisht nenit 60 të ligjit 69/2012 mund të konkurrojë për një vend pune",

thotë Ermir Kapedani, komisioner pranë institucionit të Avokatit të Popullit. Përfaqësuesit e Avokatit të Popullit kanë ngritur edhe shqetësimin e mos përfshirjes së sindikatave apo edhe vetë mësuesve në reformat që po ndërmerr ministria e Arsimit, ku kjo e fundit për nismat që ka parashikuar që lidhen me emërimin apo kualifikimin e arsimtarëve, duhet të konsultohet me grupet e interesit.

Miratohet ndërtimi i Rrugës së Arbrit, kompania kineze do të garantohet për fluksin në rrugë



Projektligji për ndërtimin e rrugës së Arbrit është miratuar në Komisionin Parlamentar të Ekonomisë. Përmes këtij projektligji, kompanisë shtetërore kineze i jepet në formë të përsheptuar e drejta e punimeve dhe administrimit të rrugës.

Ministrat nuk kanë pasqyruar shumë detaje të kontratës që do të nënshkruhet me kompaninë, por një prej detyrimeve të qeverisë vlerësohet të jete garancia e fluksit të rrugës. Kjo nënkupton pagese publike për kompaninë, në rast të një fluksi me të ulët. Kostoja e ndërtimit të rrugës së Arbrit, sipas një vlerësimi të autoritetit rrugor, do të jete 28.8 miliardë leke. Por ministri i transportit Edmond Haxhinasto, ka theksuar në Kuvend, se kompania kineze është ofruar për një vlerë deri në 25% më të ulët.

Në katër ditë 650 persona të kthyer në Durrës, do udhëtonin drejt Italisë

Policia: Nuk plotësonin dokumentacionin e duhur

Afro 650 persona janë kthyer në gjatë katër ditëve të fundit nga pika kufitare e portit të Durrësit. Burime nga policia e kufirit bëjnë të ditur se shtetasit e kthyer janë kryesisht nga jugu e veriu, të cilët nëpërmjet agjencive turistike udhëtonin në drejtim të shtetit fqinj. Sipas autoriteteve portuale emigrantet, pjesa më e madhe e personave nuk plotësonin kriteret e vendosura për personat që përket shumës monetare të cilën duhet ta kenë me vetë gjatë qëndrimit në një nga vendet e zonës Shengen, apo destinacionin dhe adresën e personit pritës. Forcimi i masave nga policia e kufirit erdhi pas numrit të lartë të atyre që dyshohet se kërkonin azil në vendet e zonës Shengen.

Fluks pasagjeresh në pikat kufitare



Vetëm në tri ditë të fundit 2500 persona kanë tentuar të largohen drejt Italisë nëpërmjet portit të Durrësit. Sipas autoriteteve të portit, 650 persona janë kthyer mbrapsht për shkaqe të ndryshme. Policia kufitare ka shtuar kontrollet e dokumenteve ndaj personave që duan të largohen duke u kërkuar garanci nga pritësi i tyre.

Kërkuan pension të parakohshëm

Ish punonjësit e Kombinatit Mekanik në Poliçan protestë para zyrave


Rreth 70 punonjës të Kombinatit Mekanik në Poliçan protestuan kundër pushimit të tyre nga puna. Sipas ish-punonjësve janë shkarkuar me motivacionin se u mbyllën vendet e punës. Protestuesit tubuan para ambienteve të kombinatit, ndërsa ata tashmë kërkojnë të trajtim të veçantë me pension të parakohshëm. Ish-punonjësit thanë se do t'i përshkallëzojnë protestat e tyre nëse kërkesat e tyre nuk do të merren parasysh.

1945/70 vjet nga gjyqi i parë special

Administrata e fashizmit ndihmonte ngritjen e çetave antifashiste



Anton Kosmaçi



Javer Hurshit

Nga Kastriot DERVISHI

(Vijon nga numri i kaluar)

Fryma e kompromisit që kishte klasa e vjetër politike ka qenë një fakt i njohur gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri. Në vitet 1939 – 1941, pothuaj në Shqipëri nuk ka pasur asnjë lloj qëndrese. Në vitet 1942 – 1943 kjo qëndresë është simbolike dhe vetëm viti 1944 është një vit aktiv i lëvizjes. Përgjithësisht administrata e kohës së fashizmit ndihmonte lëvizjen. Mirëpo kur ka ardhur koha për gjykim, kjo pjesë e kontributit apo kompromisit, harrohej ose nuk bihej në duke. Komunistët nuk njohin nder, por duan t'i gjykojnë sipas metrit të vet. Në pjesën e mëposhtme vazhdojmë shpjegimin e zhvillimit të gjyqit special nëpërmjet disa fakteve të gjykuara më të rëndësishme.

Qemal Vrioni

Akuzohej për pasojat e funksioneve shtetërore që kishte pasur si ministër

i Financave në qeverinë “Vërlaci” si dhe si “frymëzues për krimet e Isa Toskës”.

Po ashtu akuzohej se kishte përgatitur pushtimin e 7 prillit 1939 si dhe kishte marrë pjesë në shpalljen e luftës ndaj aleatëve (një ekzagjerim i pabesueshëm që rriste politikisht ndjeshëm peshën ndërkombëtare të Qemal Vrionit).

Qemal Vrioni nuk pranonte akuzën e tradhtisë së lartë. Thotë se kur G. Giro ka ardhur në Shqipëri ka qenë në burgun e Durrësit, në të cilin vuante dënimin e ardhur nga kryengritje e Fierit e vitit 1935. Vrioni ka dalë nga burgun në vitin 1938. Dy muaj para 7 prillit 1939 ishte thirrur nga ministri Musa Juka dhe ishte pyetur në kishte marrë pjesë në një mbledhje në shtëpinë e Jak Koçit ku kishin qenë edhe Shyqyri Peza, Irfan Ohri, Kapllan Deliallisi, të cilët i kishte parë të arrestuar. Pasi i ka thënë Musa Jukës se nuk kishte marrë pjesë është liruar. Njohje me konsullin italian Melloni i kishte pasur në vitin 1932 në shtëpinë e Eqrem Vlorës, ndërsa italianin

Orlandi e kishte njohur për çështje tregtie. Vrioni është bërë ministër gati një vit pas pushtimit. Nëpërmjet Vërlacit është njohur me Jakomonin. Ky i fundit i kishte kërkuar të bëhej ministër, ofertë që e kishte rinuar herën e tretë. Vrioni nuk pranonte akuzat për dhurim trojesh, ndërsa prokurori ia kthen se ai ishte “eksponent i parë i feudalizmit”.

Vrioni mohon lidhje me Isa Toskën, si dhe jep përgjigje për çështje financiare, të cigareve, etj. Ai tha se nuk kishte njohje e lidhje me Ballin Kombëtare, përveç njohje në burg më parë me Hasan Dostin e Skënder Muços.

Qemal Vrioni pohoi publikisht lidhje që kishte pasur me komunistët. Musatafa Gjinishi i ka ardhur në shtëpi dhe i ka folur për lëvizjen e tyre. Po ashtu ka biseduar me Ymer Dishnicën për organizimin e çetave antifashiste. Për çështjen e çetave ai kishte biseduar me Omer Nishanin e Gjin Markun. Qemal Vrioni vazhdonte:

“Formimi i çetave të vogla ka qenë i nevojshëm në atë kohë

sepse ngjarjet nuk kishin marrë ende përpjesëtimet e më pasme. Nuk kam kundërshtuar kurrë ndonjë lëvizje edhe kur isha në qeveri dhe as është bërë ndonjë arrestim ose vrasje”.

Qemal Vrioni në tetor 1944 ka dalë në mal, në korparmatën I, si “simpatizant i lëvizjes”. Dëshmitarë mbrojtës për të paraqiten: Panajot Nane, Aleks Gjini, Jahja Baçi, Hasan Reçi, Nuredin Aliu, Refika Hamza Vërrezha dhe dr.Gjini.

Anton Kosmaçi

Seanca e datës 5 mars fillon ora 9.00. nga të pandehurit mungonin Gustav Miradsh, Dedë Jakova, Zenel Prodan, Refat Tartari të cilët ndodheshin të sëmurë. U thirr Anton Kosmaçi, të cilit ia shkruajnë gjithnjë emrin “Andon”. Akuzohej si bashkëpunëtor i pushtuesit, rrjedhur kjo nga funksionet shtetërore që kishte pasur si prefekt në Korçë, sekretar i përgjithshëm i MPB-së, kryetar i Këshillit të Shtetit, ministër i Drejtësisë, zëvendës ministër i

DOSSIER



Qemal Vrioni



Shuk Gurakuqi

Arsimit, etj. Akuzohej se kishte marrë mobilet e legatës jugosllave të cilat qëndronin në Prefekturën e Tiranës. Mohonte akuzat duke thënë se kur ishte prefekt në Korçë ishte arrestuar vetëm Kostaq Cipo prej gjeneral Agostinucit. Kosmaçi deklaronte se çdo detyrë e kishte pranuar për të punuar “me ndërjegjen e pastër”.

Procesi vazhdon me fjalët në e dinte Kosmaçi që Eqrem Libohova ishte apo jo ballist, gjë që asnjëherë nuk është deklaruar dhe si pasojë ai i pandehuri nuk mund ta dinte.

Në lidhje me akuzat se kishte dëmtuar jugosllavët duke marrë mobilet, Kosmaçi përgjigjet se nuk i kishte përvetësuar. Kishte marrë në përdorim vetëm 3 kolltukë e një dhomë fjetjeje, të cilat i kishte pasur gjithnjë në dispozicion, Dëshmitarë mbrojtës për të paraqiten: Kostaq Cipo, Ferit Alikaj, peshkp Irene Banushi, Koçi Bezhani dhe Haki Karapici.

Zef Benusi

Ish ministri i Arsimit, akuzohej se duke qenë në këtë detyrë ishte automatikisht “armik i popullit”. Akuzohej për internime, pa asnjë akuzë të drejtpërdrejtë. Dëshmitarë mbrojtës për të paraqiten: Kostaq Cipo, Hysni Cipo, Vrisidha Kotta, Shazivar Islami.

Shuk Gurakuqi

Ish ministri i Financave deklaronte se kishte qenë privat kur ishte thirrur nga Mustafa Kruja për të qenë ministër në vitin 1942. Akuzohej se duke qenë ministër “kishte penguar luftën”. Gurakuqi pohonte se nuk ishte marrë kurrë me politikë, por vetëm me çështje financiare. Si “prova” prokurori tregon disa akte ekzekutimesh me

vdekje për Ferit Xhajnun, Nikolla Tupen, Hamdi Mëzezin, të cilat nuk lidhen me detyrën e ministrit të Financave. Gurakuqi pohonte se për 14 vjet (1914 – 1938) kishte qenë jashtë Shqipërisë si antizogist. Gjatë kësaj kohe kishte qëndruar në Trieste duke u marrë me tregti pranë familje së Agostin Serreqit. Me vdekjen e Nikolla Serreqit, në vitin 1938 u kthye në Shqipëri. Sipas tij Mustafa

qeverinë e Mustafa Krujës. Kotte deklaronte se akuzat nuk i përgjigjeshin të vërtetës. Mustafa Krujën e kishte njohur në vitin 1914, e më pas kishte bashkëpunuar me të në vitet 1916 – 1917, 1922 – 1924. Në emigrim politik, në vitet 1925 – 1938 ka jetuar në Gjenevë. Atje e ka gjetur Mustafa Kruja, të cilin e kishte mik. Edhe Kotte deklaronte se Mustafai nuk kishte grup politik por vetëm shokë.

Në qershor 1939 kishte ardhur “në mënyrë jo të turpshme në Shqipëri” dhe me ndërhyrjen e disa miqve ishte emëruar drejtor i përgjithshëm i Shtypit, Propagandës dhe Turizmit. Pas mbarimit të detyrës së ministrit ishte emëruar në Ministrinë e Kulturës Popullore. Ndërsa nxjerrja e gazetës “Roja Kombtare” kishte qenë një nismë private. Gjatë kësaj kohe lindi një konflikt midis Mustafa Krujës dhe Ali Këlcyrës. Për këtë arsye, gazeta boton marrëveshjen në qershor 1938 me ndërmjetësimin italian të dy të parëve dhe Qazim Koculit për

rrëzimin e Mbretit Zog. Dëshmitarë mbrojtës për të paraqiten: Muharrem Vllamasi, Sotir Kondi, Abaz Xhomo, Malo Frashëri.

Emin Toro

Akuzohej se si nënkryetar i parlamentit kishte bashkëpunuar për miratimin e ligjeve. Toro shkruan se pushtimi e kishte gjetur sekretar të përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë. Kur kishte qenë në inspektim të gjykatave në Shkodër, kishte marrë vesh emërimin si nënkryetar i parlamentit. Po ashtu në vitin 1942 kishte qenë edhe nënkryetar i Drejtësisë. Dëshmitarë mbrojtës për

të paraqiten: Enver Zazani, Vangjel Meksi, Miti Evangjeli, Selaudin Toto, Andrea Nathanailli, Selaudin Kokona, Skënder Topulli. Si edhe të tjerët pyetj për masakrën e 4 shkurtit 1944, ndonëse pa lidhje me të.

Zef Shiroka

Ish ministri njëmujor i Industrisë dhe tregtisë në qeverinë e Maliq Bushatit, akuzohej se nga kjo cilësi ishte “armik i popullit”. Vinte nga përvoja të mëparshme si kryetar i Bashkisë së Shkodrës apo kryenëpunës i nozullimeve. Deklaron se pranoi me merrte pjesë në qeverinë “Bashati”, pasi kjo krijoi xhandarmërisë shqiptare dhe se kishin bërë punë të mira.

Javer Hurshit

Më 7 mars 1945, ora 9.00, seanca rifillon me pyetjen e Javer Hurshitit. Akuzohej për cilësitë e tij si prefekt në Shkodër, inspekto në Kryeministri, komisar i jashtëzakonshëm në Gjirokastër, anëtar i Këshillit të Shtetit dhe ministër i Kulturës Popullore. Ai shpjegon komplotin e vitit 1939 nga Giro kundër Zogut, si tjetër të ngelur në orvatje. Sipas tij qeveria e Maliq Bushatit nuk kishte lidhje me Ballin Kombëtar. Për emërimin në Këshillin e Shtetit, Hurshit thotë se ky institucion në këtë kohë quhej “klub pensionistësh”. Kur ishte varrosur Gjergj Fishta, kishte udhëtuar nga Tirana në Shkodër së bashku me Mustafa Krujës, rast ky që kishte shërbyer si prezantim me njëri – tjetrin. Hurshit deklaronte se aktivitetin patriotik e ka filluar qysh në vitin 1918. Dëshmitarë mbrojtës për të paraqiten: Muzafer Pipa, Kasem Radovicka, Sejfi Vllamasi, Reis Selfo, Ismet Grapshi.



Zef Benusi

Kruja nuk kishte pasur grup politik, por një grup miqsh si Xhevat Korça, Riza Dani, etj. Gurakuqi deklaronte se gjatë luftës Shqipëria nuk kishte inflacion. Kishte gjetur (dhjetor 1941) një shumë prej 10 milion frangash dhe kur kishte ikur (janar 1943) kishte lënë më shumë se kaq. Seanca e datës 6 mars 1945 filloi ora 9.00 prapë me Shuk Gurakuqin.

Kostandin Kotte

Seanca vazhdoi me Kotten i cili akuzohej për veprimtarinë e para vitit 1939, si drejtor i shtypit pas vitit 1939 dhe si ministër i Ekonomisë Kombëtare në vitin 1942 në



DOSSIER




Shtëpia Botuese "55"

Botimet e reja

"Nga Nairobi në Shenzen"

NGA MARK OBAMA



Botimi më i ri
Shtëpisë botuese
"55" është një romani
i dashurisë në Lindjen
e Largët, i cilësuar
nga kritika amerikane
si romanca për t'u lex-
uar në stinën e verës

"Djali mulat i një akade-
miku kenian të shkëlqy-
er, por të trazuar, dhe
i një amerikaneje të
bardhë, shkruan një
libër me ndjenja të
forta emocionale rreth
rrugës së tij në kërkim
të identitetit dhe vet-
vetes."

Washington Post

Botimet e reja

SHBA: Kompromis për marrëveshjen bërthamore me Iranin

Kerry: Përballë kemi sfidën e përfundimit të negociatave

Sekretari amerikan i shtetit, John Kerry, thotë se beson se Shtetet e Bashkuara dhe partnerët e vet në bisedimet me Iranin, për programin bërthamor të tij, mund të zhvillojnë negociata për marrëveshje, e cila “botën do ta bëjë më të sigurt”.

Sekretari amerikan i shtetit, John Kerry, thotë se beson se Shtetet e Bashkuara dhe partnerët e vet në bisedimet me Iranin, për programin bërthamor të tij, mund të zhvillojnë negociata për marrëveshje, e cila “botën do ta bëjë më të sigurt”. Gjashtë fuqitë botërore dhe Irani, më 2 prill janë pajtuar për marrëveshjen kornizë, me të cilën do të kufizohen aktivitetet atomike të Iranit, duke ia vështirësuar Iranit zhvillimin eventuale të armatimit bërthamor, nëse ai përpiqet ta bëjë këtë, në këmbim për lehtësim të sanksioneve të Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara. Palët e kanë përcaktuar afatin e fundit, 30 qershorin, për arritjen e marrëveshjes finale. Në komentet e së mërkurës, pasi arriti në Luebek të Gjermanisë për takimin e ministrave të jashtëm të grupit G7, zoti Kerry tha: “Natyrish, tash ballafaqohemi me sfidën e përfundimit të negociatave gjatë dy muajve e gjysmë. Të martën është arritur kompromis në Uashington lidhur me përfshirjen e Kongresit. Ne jemi të sigurt për aftësinë tonë që presidenti të negociojë një marrëveshje dhe ta bëjë atë me aftësi që ta bëjë botën më të sigurt”, tha John Kerry. Kjo ishte një referencë për legjislacionin, me të cilin Kongresi i Shteteve të Bashkuara do të rishqyronte marrëveshjen atomike me Iranin. Komiteti për Marrëdhënie të Jashtme i Senatit amerikan, ka votuar 19:0 në favor të versionit të plotësuar të Aktit Për Rishqyrtimin e Marrëveshjes Atomike me Iranin të vitit 2015. Presidenti amerikan Barack Obama, ishte kërcënuar me shfrytëzim të vetos ndaj versionit të mëparshëm të legjislacionit, por kundërshtimet e tij i ka tërhequr pasi demokratët dhe republikanët arritën kompromis për këtë masë, duke i larguar disa propozime, për të cilat Shtëpia e Bardhë kishte shqetësime se do t'i



dëmtonin rëndë gjasë për arritjen e marrëveshjes.

Zëdhënësi i Shtëpisë së Bardhë, Josh Earnest, tha se nëse ndryshimet e propozuara bëhen gjatë një procesi legjislativ, atëherë “do të ishte një lloj kompromisi që presidenti do të ishte i gatshëm ta nënshkruaj”. Në këtë temë, kryesuesi i Komitetit për Marrëdhënie të Jashtme të Senatit, republikani Bob Corker, theksoi: “Kongresi mbetet i involvuar – nëse arrihet marrëveshje ose nëse nuk miratohet. Çdo 90 ditë, administrata duhet të certifikoj se në çdo drejtim Irani po bashkëpunon. Nëse ka shkelje, brenda periudhës

10 ditëshe, ata duhet ta paraqesin këtë në Kongres, kështu që ne kemi mundësi, nëse ne dëshirojmë, që shpejt t'i ri-zbatojmë sanksionet”, tha Bob Corker. Propozimi aktual, që tash shkon në përbërjen e plotë të Senatit, për votim dhe debat, e përcakton një periudhë 30 ditëshe për rishqyrtim të Kongresit, nëse Obama e dërgon tekstin e plotë të marrëveshjes finale për programin bërthamor iranian, deri më 9 qershor. Në një leshim ndaj Shtëpisë së Bardhë, kjo periudhë ishte zvogëluar prej 60 ditësh, sa ishte propozuar fillimisht. Në një koncesion tjetër, legjislacioni i rishqyrtuar e bënë

më pak të mundshme që sanksionet do të imponoheshin kundër Iranit lidhur me akuzat për terrorizëm. Sipas legjislacionit të rishqyrtuar, administrata Obama duhet t'i dërgojë Kongresit raporte periodike për aktivitetet e Iranit lidhur me raketat balistike dhe terrorizmin, por këto raporte nuk do të shkaktojnë ndonjë rund tjetër të sanksioneve. Gjatë periudhës së rishqyrtimit, Obama do të ketë të drejtë t'i tërheqë sanksionet kundër Iranit, nëpërmjet aksionit presidencial, por do të bllokohet nga lehtësimi i sanksioneve që janë imponuar nga Kongresi.

Ministrat e jashtëm të G7 takohen në Lybek të Gjermanisë

“Acht geben”, gjen të shkruar në tabela të vogla të verdha, të vendosura në parqet e Lybekut. Një lojë fjalësh, që do të thotë kini kujdes, por edhe jep tetë. Një tregues për atë, që shumë kritikë do të kishin dashur që Rusia të merrte pjesë në këtë takim të rëndësishëm. Pra tetë ministra të jashtëm, jo vetëm shtatë, nga Kanadaja, Italia, Britania e Madhe, Franca, Japonia, SHBA dhe Gjermania. Ministri i Jashtëm, Frank-Walter Steinmeier, nuk e ka ftuar Rusinë. Pas anektimit të Krimesë, në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, nuk mund të bësh, sikur nuk ka ndodhur asgjë, shkroi Steinmeier në një artikull gazete. Në të njëjtën kohë ai theksoi se Rusia nuk

duhet të izolohet përgjithmonë. Dhe sikur të donte ta theksonte këtë, ai ftoi në Berlin homologët e tij nga Franca, Ukraina dhe Rusia para takimit të G7. Në takimin e të katërtëve të hënën në mbremje (13.04.) u diskutua për paqen në lindje të Ukrainës. Bisedimet qenë të lodhshme, u tha në Ministrinë e Jashtme. Megjithatë ministri i Jashtëm Steinmeier u shpreh, se shih përparime: “Vendimtare është, që megjithë acarimin e situatës sot kemi rënë dakord, jo vetëm për të vazhduar tërheqjen e armëve të rënda, por për të përfshirë në tërheqje edhe kategori të tjera të armëve.” Kështu në të ardhmen ne do të tërheqim edhe tanke, automjete të blinduara dhe mortaja. Përveç kësaj

katër ministrat e jashtëm vendosën të ngrenë grupe pune. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë duhet forcuar. Duhet të fillohet të jepet ndihma humanitare, në lindje të vendit duhet të ketë zgjedhje që këtë vit.

Kjo temë preokupon edhe ministrat e G7 në takimin e tyre të mbremjes (14.04) në Lybek. Steinmeier raporton mbi takimin e një dite më parë me homologët e tij nga Franca, Ukraina dhe Rusia. Për qeverinë gjermane është e rëndësishme që kombet e mëdha industriale të tregojnë unitet lidhur me këtë temë. Nesër do të jenë në axhendë tema të tjera: siguria detare, ndryshimet klimatike dhe ndikimi i tyre, konflikti në Jemen,

bisedimet me Iranin, lufta kundër terrorizmit dhe Afrika. Policia pret rreth 5000 pjesëmarrës në demonstrata të ndryshme dhe 3500 policë janë në gatishmëri për të mbrojtur ministrat e shtatë vendeve të industrializuara, në takimin e tyre dyditor. Për këtë shkak ka pengesa në qarkullimin rrugor. Të hënën u zhvillua protesta e parë. Disa qindra pjesëmarrës kaluan nëpër qytetin e Lybekut të shoqëruar me muzikë tekno. Maren Janotta një zëdhënëse e protestuesve u shpreh: “Sonte duam të demonstrojmë kundër takimit të ministrave të jashtëm të G7 në Lybek, ne nuk jemi dakord me politikën e tyre dhe kërkojmë që të mund të lëvizim gjithmonë të lirë në qytetin tonë.”

Shtëpia Botuese "55"

Botimet e reja

Katerina e Madhe dhe Potemkini

SIMON SEBAG
MONTEFIORE



*Katerina e Madhe
dhe Potemkini*

HISTORI DASHURIE PERANDORAKE



“Ky libër është një tregim mbi historinë më të madhe të dashurisë në kohërat moderne... Kontradiktat në karakterin e Potemkinit dalin në mënyrë të mrekullueshme në këtë biografi madhështore”. “Petronella Wyatt, Independent”.
Libri është përkthyer në shqip nga

Abdullah Sollaku dhe
Ergys Petriti

Botimet e reja



Roland Sejko, me film mbi vizitën e Papa Françeskut në Shqipëri

Filmi dokumentar mbështet në materiale arkivore dhe historike, ndërthurur me filmime nga vizita e Papa Françeskut dhe momente nga teksti i veprës së At Zef Pllumit, "Rrno për me tregue".

Regjisori Roland Sejko rikthehet në ekranin e kinemasë me një tjetër film dokumentar. Frymëzuar nga vizita e Papa Françeskut në Shqipëri, autori sjell filmin me titull "Pritja", i cili do të shfaqet premierë nesër mbrëma në kinema Millenium.

Papa Françesku vizitoi Shqipërinë me 21 shtator 2014.

Në sfondin e kësaj vizite, regjisori Roland Seiko rrëfen një periudhë të historisë së Shqipërisë ku liria e

besimit ishte e ndaluar.

Filmi dokumentar mbështet në materiale arkivore dhe historike, ndërthurur me filmime nga vizita e Papa Françeskut dhe momente nga teksti i veprës së At Zef Pllumit, "Rrno për me tregue".

Premiera e filmit "Pritja" që zgjat 1 ore, po aq sa edhe udhëtimi i Atit të Shenjtë nga Roma në Tiranë, do të shfaqet mbrëmjen e së mërkurës në kryeqytet.

Ekspozita "Noli - Konica, Albumi i një bashkohësie" prezantohet në Prishtinë

Librat, dorëshkrimet, fotografitë, citatet e shënimit, apo edhe lapsi dhe oboja e famshme e Nolit, monografia e Konicës, si dhe skulptura medalion e Nolit, janë prezantuar për shqiptarët e Kosovës, të cilët e kanë mikpritur ekspozitën



Ekspozita "Noli - Konica, Albumi i një bashkohësie" ekspozitë kushtuar dy figurave të shquara të jetës kulturore, politike, letrare e shoqërore të vendit. Fan Noli dhe Faik Konica, pasi u çel në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë, ka udhëtuar drejt Prishtinës ku në ambjentet e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani", është çelur në kuadër të Javës së Bibliotekës në Kosovë. "Java e bibliotekës në Kosovë", aktivitetit i organizuar nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës dhe Ambasada Amerikane në Prishtinë, 14 deri më 18 prill, ka përfshirë si pjesë të kalendarit të veprimtarive kulturore,

dhe prezantimin e ekspozitës e organizuar në kujtim të 50-vjetorit të vdekjes së Nolit dhe 140-vjetorit të lindjes së Konicës, (respektivisht më 13 dhe 15 mars).

Librat, dorëshkrimet, fotografitë, citatet e shënimit, apo edhe lapsi dhe oboja e famshme e Nolit, monografia e Konicës, si dhe skulptura medalion e Nolit, janë prezantuar për shqiptarët e Kosovës, të cilët e kanë

mikpritur ekspozitën e cila përveç prezantimit për herë të parë të disa objekteve nga dy personalitetet, ka si qëllimin dhe vënie në dukje të kontributit të përbashkët të Nolit dhe Konicës si shkrimtarë, përkthyes, kritikë letrarë e kritikë sociale, dijetarë të hollë në debatet ndërkombëtare të kulturës botërore por edhe polemistë të guqishëm ndaj zhvillimeve politike jo vetëm Shqiptare por edhe rajonale e europiane.



Vdes profesori i fagotit, Fatos Jaho

Jaho ishte njeriu që hapi shkollën e Fagotit dhe i kontribuoi Filarmonisë së Kosovës prej themelimit të saj.

Është ndarë dje nga jeta instrumentisti Fatos Jaho (1957- 2015). Tërë jetën Jaho ia dedikoi instrumentit të fagotit, jo vetëm në skenë, por edhe si pedagog në Universitetin e Arteve. Fatosi ishte simbol i talentit, punës së madhe, pasionit, i profesorit nga duart e të cilit kanë dalë mjaft fagotistë, simbol i energjisë, aftësive organizative për të krijuar formacione dhome me instrumente fryme e kuartete fagotash, i palodhur për të luajtur në të gjitha formacionet muzikore shqiptare në Tiranë e

Prishtinë". Por sipas profesorit, ajo çka e karakterizonte Fatosin veç respektit artistik, që kishin gjithë muzikantët ishte se, qe njeri me cilësi e virtyte të rralla. Mirësia dhe miqësia e tij ishte e rrallë dhe për t'u admiruar". Fatos Jaho nuk do t'i mungojë memories se muzikës shqiptare, sepse jeta e tij është fiksuar në DVD, ekran, regjistrime, dhe do të jetë një pike reference për brezat e rinj të muzikantëve. Ai ishte nga Shqipëria, por jetonte mes Tiranës dhe Prishtinës. Punoi si pedagog i fagotit në të dyja vendet.

Kosova, pjesëmarrëse në konferencën për Muzetë në Novi Sad

Rreth 90 profesionistë të trashëgimisë kulturore dhe muzeve nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Gjermania, Maqedonia, Mali i Zi, Mbretëria e Bashkuar, Serbia dhe Suedia po marrin pjesë nga data 15 deri në 17 prill, 2015 në Novi Sad, në konferencën e tretë vjetore të muzeve të titulluar "Meet, See, (critically) Do" – "Njihuni, Shihni, Veproni (kritikisht)".

Konferenca është organizuar nga Rrjeti Ballkanik i Muzeve (BMN) dhe Fondacioni Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHWB) në partneritet me Muzeun e Vojvodinës, Novi Sad.

Si një nga konferencat më të mëdha në Ballkanin Perëndimor ajo ka për qëllim zhvillimin individual dhe institucional të muzeve, gjithashtu të inkurajojë dhe frymëzojë bashkëpunimin e muzeve në rajon. Folësit kyç të konferencës këtë vit janë ekspertë të



shquar të muzeologjisë dhe trashëgimisë me eksperiencë rajonale dhe ndërkombëtare, prof dr Tomislav Shola, Anna Viola Hallberg, Nat Edwards, Stephen Allen, Michele Taylor dhe 6 profesionistë

nga Ballkani Perëndimor të cilët po zhvillojnë strategji të ndryshme për përfshirjen e komunitetit së bashku me kolegë nga Mbretëria e Bashkuar.

Bogdan Shekariq, nga muzeu i Vojvodinës, deklaroi rreth rëndësisë së këtij aktiviteti se "Një nga vlerat kryesore e kësaj Konference është rilidhja e lidhjeve të vjetra krijimi i bashkëpunimeve të reja, mes muzeve të rajonit. Ngjarjet dramatike e dekadave të fundit kanë ndryshuar fatet tona, kanë lënë pas

dore lidhje krijimi i të cilave është i vështirë për shkak të kontekstit të tanishëm politik dhe shoqëror".

"Në konferencën në Novi Sad, ligjërues me eksperiencë nga rajoni dhe vende të tjera të Evropës do të prezantojnë dhe do të hapin dialogun mbi qasjen kritike ndaj muzeve në Ballkan, rolin e muzeve në shoqëri, përfshirjen e komunitetit, politikën ndërkulturore dhe muzetë, art dhe aktivizëm, interpretim dhe teknika rrëfimi. Kjo Konference na jep mundësinë të përditësohemi

me problematika të përbashkëta të punës tonë", u shpreh Bogdan Shekariq, zëvendës drejtor i Muzeut të Vojvodinës.

"Jemi të nderuar që marrim pjesë në këtë Konferencë që ndihmon muzetë dhe profesionistët e rajonit. Pjesëmarrja në konferencë na konfirmoi që muzetë kanë kuptuar rëndësinë e bashkëpunimit për zhvillim dhe për krijim të kushteve më të mira për qytetarët dhe institucion", theksoi Tatjana Cvjetičanin, presidentja e Bordit të Rrjetit Britanik të Muzeve.

“Kosova Fest”, sivjet në shesh

Drejtori i këtij festivali, Valdet Sopiani tha se gjithçka është duke u bërë në përgatitje sa më të mirë për këtë festival, i cili para disa kohëve ka hapur edhe afatin e aplikimit për të qëndruar i hapur deri me datën 30 të këtij muaji

Kosova Fest këtë vit shënon edicionin e trembëdhjetë më radhë. Që nga viti 2001 kur dhe ka qenë edicioni i parë i tij ky festival çdo vit mëton të nxjerr emra të rinj e të talentuar të muzikës. Drejtori i këtij festivali, Valdet Sopiani tha për KultPlus se gjithçka është duke u bërë në përgatitje sa më të mirë për këtë festival, i cili para disa kohëve ka hapur edhe afatin e aplikimit për të qëndruar i hapur deri me datën 30 të këtij muaji. “Festivali Kosova Fest”, është në përgatitje të vazhdueshme. Këtë edicion festivali do të mbahet në ambient të hapur, do të jetë në sheshin “Nënë Tereza”, tha Sopiani. Sipas tij kriteret për të qenë pjesëmarrës në këtë festival, i

cili momentalisht edhe është i vetmi në vend i llojit të tillë, duhet që kënga të jetë e pa dëgjuar më parë. “Deri me tani kemi pasur kërkesa të shumta nga këngëtarët për të qenë pjesëmarrës të Kosova Festit. Festivali ka për qëllim që të ju jap hapësirë më shumë talenteve të rinj të cilët duan të hyn në rrugën e muzikës” tregoi Sopiani. Ai gjithashtu bëri të ditur se Kosova Fest do t’i ketë dy mbrëmje. Atë të fëmijëve dhe të rriturve, që të dy mbrëmjet do të kenë nga pesëmbëdhjetë pjesëmarrës. Sipas Sopianit për seleksionimin e këngëve që do të aplikojnë do të formohet një juri në përbërje të tre personave të cilët do të jenë profesionist të fushës

së muzikës, por që ende nuk janë vendosur se kush do të jen ata persona. Ai gjithashtu bëri të ditur që për të organizuar një festival të tillë është mjaftë e vështirë, si për nga ana e stafit por edhe për nga ana financiare. “Është shumë e vështirë për të organizuar një festival, ne jemi dëshmitarë të asaj se përveç Kosova Festit kanë ekzistuar edhe dy festivale shumë të suksesshme por që më kalimin e kohës janë shuar, nuk kanë mundur t’i rezistojnë kohës për shkak të vështirësive që hasim”, pohoi Sopiani. Ai tha se Kosova Fest do të mbahet në fund të muajit qershor ose në fillim të muajit korrik, varësisht nga përgatitjet e festivalit.



“Lufta në kohën e dashurisë”, premierë me pesë maj

“Lufta në kohën e dashurisë”, është një komedi e shkruar nga dramaturgu, Jeton Neziraj dhe vjen nën regjinë e Blerta Nezirajt, sipas së cilës, titulli i kësaj performaceje është si një lloj loje fjalësh nga titulli i romanit të Markezit “Dashuria në kohën e kolerës”

Në shfaqjen “Lufta në kohën e dashurisë”, katër gra të çuditshme të Kosovës rrëfejnë intimitetet, pasionet, marrëzitë, sekretet dhe dëshirat e tyre. Ato kanë krijuar një botë të përbashkët imagjinare, ku loja e argëtimi bëhen streha e tyre për të mbijetuar. Në shfaqje, si në përrallat me magjistare, shpalosen me humor, stereotipe e klishe sentimentale, tregime e muhabete grash: për dashurinë, frikën, hakmarrjen, e të shkuarën e trishtë. “Lufta në kohën e dashurisë”, është një komedi e shkruar nga dramaturgu, Jeton Neziraj dhe vjen nën regjinë e Blerta Nezirajt, sipas së cilës, titulli i kësaj performaceje është si një lloj loje fjalësh nga titulli i romanit të Markezit “Dashuria në kohën e kolerës”. “Komedia është shkruar nga Jeton Neziraj, diku në fund të vitit 2007. Nga koha kur është shkruar ka pasur disa inskenime e lexime skenike jashtë Kosove (përfshi edhe inskenimin që iu bë vjet në Paris, nga teatri “Termos”). Megjithatë, është hera e parë që kjo komedi do të shfaqet para publikut kosovar”, tha ndër të tjera për KultPlus, regjisorja, Blerta Neziraj.



Kjo është një shfaqje performancë e cila përmban në vete shumë elemente muzikore dhe të vallëzimit, e për këtë arsye sipas regjisorës provat për këtë shfaqje kanë filluar qysh në fillim të muajit shkurt, ku sipas Nezirajt është dashur të punohet përgjatë tre muajve shkaku i kompleksit stilistik e estetik. Në kastën e aktorëve të kësaj performace janë: Aurita Agushi, Shengyl Ismaili, Shkëlzen Veseli, Albulena Kryeziu dhe Molikë Maxhuni të cilët do të interpretojnë personazhe të ndryshme brenda shfaqjes. “Jam shumë e lumtur me punën e aktorëve,

me disa prej të cilëve po punoj për herë të parë. Thjesht, bëhet fjalë për aktorë të shkëlqyeshëm që, kanë pranuar, pa hezitim, t’i hyjnë kësaj “aventure” teatrore, jo fort të kollajshme. Dhe jam e sigurt që me ta do të punoj sërish në të ardhmen”, u shpreh Blerta Neziraj. Shfaqja do të zgjatë jo më shumë se 90 minuta, ndërsa premiera e saj do të jetë më datën 5maj në ora 20:00 në Prishtinë, kurse për vendin se ku do të jepet kjo shfaqje ende nuk dihet. “Shfaqja do të jepet në njërin prej teatrove të Kosovës”, përfundoi Neziraj.

Miratohen katër shfaqje në repertorin e TKK-së për vitin 2015

Këshilli Drejtues gjithashtu ka konstatuar se, përveç këtyre projekteve të aprovuara, për repertorin e vitit 2015 ka akoma hapësirë edhe për një apo dy projekte të tjera – na varshmëri me rrethanat buxhetore të TKK-së

“Ferma e Kafshëve”, nga George Orwell me regji të Ilir Bokshit, “Nana dhe fëmija”, nga Jon Fosse me regji të Bekim Lumit, “Gishti”, nga Doruntina Basha, me regji të Erson Zymberit dhe “Elektrës i ka hije zija”, nga Eugene O’Neill me regji të Kushtrim Bekteshit janë shfaqjet që kanë kaluar nga Këshilli Drejtues i TKK-së, për të qenë pjesë e repertorit të vitit 2015. “Në mbledhjen e mbajtur me datë 14 prill 2015, mbas propozimeve të u. d Udhëheqësit Artistik, Këshilli Drejtues i TKK-së, me shumicë votash, ka aprovuar për repertorin e vitit 2015 këto projekte teatrore”, është thënë në komunikatën e lëshuar

nga Teatri Kombëtar i Kosovës. Ndërkohë, Këshilli Drejtues ka rekomanduar që drama “Gishti”, nga Doruntina Basha, me regji të Erson Zymberit, e propozuar nga u.d Udhëheqësi Artistik për skenë të madhe, të bartet si projekt për formatin e skenës së vogël të TKK-së. “Këshilli Drejtues gjithashtu ka konstatuar se, përveç këtyre projekteve të aprovuara, për repertorin e vitit 2015 ka akoma hapësirë edhe për një apo dy projekte të tjera – në varshmëri me rrethanat buxhetore të TKK-së. Në këtë rast, Këshilli Drejtues ka sugjeruar që, nga këto dy projekte të mundshme, së paku njëri të jetë nga dramaturgjia shqipe.

Filmi “Heroi”, me çmim në Los Angeles Independent Film Festival

„Best Ensemble Cast” është çmimi i fundit që i është ndarë filmit “Heroi”, në Los Angeles Independent Film Festival

Filmi i metrazhit të gjatë “Heroi”, me regji të Luan Kryeziut së fundi është shpërblyer edhe me një çmim. Sipas regjisorit, Luan Kryeziu filmi është shpërblyer me çmimin „Best Ensemble Cast” në Los Angeles Independent Film Festival. Filmi “Heroi”, për bosht ka mostrajtimin e duhur të një ushtari të UÇK-

së në periudhën e pasluftës, i cili bën përpjekje të sigurojë kushte elementare të jetës për gruan dhe djalin e tij. Në këtë film me rolet kryesore janë përfshirë Arben Bajraktaraj dhe Adriana Morina. Filmi “Heroi”, që nga prezantimi i premierës e deri më tashti është shpërblyer me çmime të ndryshme në festivale.

“Burrneshat” në mesin e filmave premtues të “Tribeca Film Festival”

Filmi që shtjellon traditën shqiptare e që mes tjerësh është bashkëfinancuar edhe nga Kosova, është përmendur mes 10 filmave më premtues të festivalit prestigjioz.

Në një kritikë të botuar në “indiewire.com”, për “Tribeca Film Festival”, që nis sot (e mërkurë), filmi i regjisores Laura Bispuri, ku luajnë edhe aktorët kosovarë Ilire Vinca-Çelaj e Luan Jaha, përmendet mes 10 filmave “për femra dhe të realizuar nga femrat që na kanë rënë në sy, na kanë zaptuar imagjinatën dhe premtojnë të hapin mendjet tona”.

“Ka shumë për çka mund të flitet për edicionin e këtij viti të ‘Tribeca Film Festival’. Për fillim, 33 për qind e filmave artistikë që do të shfaqen janë realizuar nga femrat, që është përqindja më e lartë në historinë e këtij festivali. Këtu janë 10 filmat për femra dhe të realizuar nga femrat që na kanë rënë në sy, na kanë zaptuar imagjinatën dhe premtojnë të hapin mendjet tona. Me tema që shtjellojnë muzikën e Pakistanit, komeditë romantike dhe rimëkëmbjen pasi humb një fëmijë, ‘Tribeca 2015’ ka shumë për të ofruar”, shkruan “indiewire.com”, tek shtjellon rrëfimin e filmit “Sworn Virgin”. “Burrneshat” në fillim të prillit mori çmimin “Firebird Award”, që është kryesori në garën e filmbërësve të rinj të Festivalit Ndërkombëtar të Filmit në Hong-Kong.

Artikulli i shkruar nga Laura Berger përgjigjet edhe në pyetjen se pse duhet t'i interesojë audiencës amerikane ky film, duke thënë se para se “Burrneshat” të shfaqej në Festivalin e Filmit në Berlin, kjo audiencë ishte krejtësisht e pafamiljarizuar me traditën shqiptare për burrneshat, një traditë shakullore.

“Sikur e përshkruan ‘Tribeca...’, filmi ‘Sworn Virgin’ vë në dukje zakonet që t'i lejojnë gratë të thyejnë rolet e tyre të përcaktuara dhe t'i shmangen jetës familjare duke zgjedhur të marrin rolin e ngurtë të



një tjetër gjinie”. Ne ishim të rrëmbyer nga filmi debutues i Laura Bispurit, që e shtjellon këtë temë me besim dhe ndjeshmëri. Alba Rohrwacher jep një performancë të mrekullueshme në rolin e Hanës e Markut, një grua që zgjedh të jetojë si burrë dhe pastaj ndërro mendjen e saj apo të tij”, shkruhet në artikull tek citohet Bispuri që në një intervistë për “Women and Hollywood” kishte thënë se i gjithë filmi është “një shtegtim brenda shpirtit të personazhit, me befasi të vazhdueshme të metamorfozave të vogla e të mëdha”. “Sikur në të gjitha udhëtimet, shikuesi përjeton ndjenja dhe emocione të ndryshme: befasinë, parashikimin, keqkuptimin, mirëkuptimin, kureshtjen. Janë të gjitha pjesë që bashkohen në mënyrë harmonike si mozaik për të rrëfyer një histori të madhe dhe për të zbuluar një personazh të madh. Ju e shoqëroni atë në një udhëtim që shpallet për të zbuluar identitetin e të qenit i liruar”, citohet të ketë thënë Bispuri. Siç përshkruhet në këtë kritikë, “Sworn Virgin” flet për Hanën (Alba Rohrwacher), një grua të re që jeton brenda kufijve të një fshati në Shqipërinë Veriore dhe dëshiron t'i shpëtojë prangosjes së të qenit grua dhe të jetojë jetën e saj si mashkull. Për ta bërë këtë ajo duhet t'i bindet ligjit

të vjetër të Kanunit dhe të betohet se do të mbetet e virgjër përgjithmonë. Vite më vonë, si Mark, ajo e braktis shtëpinë për herë të parë dhe udhëton për në Itali për të qëndruar me motrën e saj, duke u përballur me një botë që nuk e kishte njohur më parë. Atje, ajo zbulon veten përsëri, gjë që e çon atë në rishqyrtimin e betimit që kishte bërë më herët.

Mes 10 filmave më premtues për femrat e të realizuar prej tyre përmenden edhe “Meadowland” nën regji të Reed Moranos, “Man Up” nga Tess Morris, “Bleeding Heart” nga Diane Bell, “Roseanne for President”, “The Armor of Light”, “Thought Crimes”, “Song of Lahore”, “All Eyes and Ears” dhe “Code: Debugging the Gender Gap”. Në festivalin e “Tribecas...”, “Burrneshat” është në garë në kategorinë “World Narrative Feature Competition”, përkrah me filmat si “The Adderall Diaries” të regjisores Pamela Romanowsky (me protagonist James Franco), “Franny” nën regji të Andrew Renzit, që ka protagonist aktorin Richard Gere, “Men Go to Battle” nën regji të Zachary Treitz, “Dixieland” nën regji të Hank Bedford etj. Në shkurt “Burrneshat”, që është bashkëprodhim i Italisë, Zvicrës, Gjermanisë, Shqipërisë dhe Kosovës, që ka kontribuar me 50 mijë euro, pati premierën në “Berlinale”.

12 autorë fitojnë çmimin për Letërsi nga Bashkimi Evropian

Të gjithë fituesit marrin shpërblimin prej 5 mijë eurosh, si dhe do të promovohen në disa shtete evropiane. Ceremonia e ndarjes së

shpërblimeve do të bëhet gjatë muajit qershor në Bruksel.

Carolina Schutti nga Austria, Luka Bekavac nga Kroacia, Gaëlle Josse nga Franca, Edina Szvoren nga Hungaria, Donal Ryan nga Irlanda, Lorenzo Amurri nga Italia, Undinė Radzevičiūtė nga Lituania, Ida Hegazi Høyer nga Norvegjia, Magdalena Parys nga Polonia, David Machado nga Portugalia, Svetlana Žuchová nga Slovakia dhe Sara Stridsberg nga Suedia janë 12 fituesit e sivjetmë të çmimit evropian për Letërsi i cili ndahet nga Bashkimi Evropian.

Të gjithë fituesit marrin shpërblimin prej 5 mijë eurosh, si dhe do të promovohen në disa shtete evropiane. Ceremonia e ndarjes së shpërblimeve do të bëhet gjatë muajit qershor në



Bruksel.

Komisioneri për Kulturë i Bashkimit Evropian, Tibor Navratsics tha se letërsia i hap mendjet e njerëzve.

“Me këtë çmim ne duam ti shpërblejmë më të mirët, ata të cilët letërsinë po e shohin në korniza të tjera. Do të vazhdojmë ti përkrahim autorët e shteteve evropiane, sepse qëllimi kryesor i letërsisë është të thyejmë tabutë dhe kufinj të fizikë” shton Navratsics.

U hap ekspozita mbi historikun e botimit letrar shqip 1949-1969

Në kuadër të javës së Bibliotekës së Kosovës, ditën e së mërkurës u hap ekspozita “Historiku i Botimit Letrar Shqip (1949-1969)” me tituj të zgjedhur. Këtë ekspozitë e hapi shefja e Departamentit të Koleksioneve të Veçanta në Bibliotekën e Kosovës, Bedrije Mekolli e cila tha se kjo ekspozitë përmban gjithsej 400 njësi të cilat janë kryesisht të autorëve të të gjitha trevave shqipfolëse.

“Këtu kemi kryesisht rilindasit dhe autorët e letërsisë moderne shqipe të gjysmës së parë të shekullit XX, ndërsa kemi edhe autorë të huaj të përkthyer në gjuhën shqipe. Këtu janë gjithsej 105 autorë shqiptarë, 66 jugosllavë, 20 rusë, 21 angloamerikan dhe ata autorë të letërsisë së vjetër greke”, theksoi Mekolli.

Nga këta tituj të ekspozuar në hollin e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës gjysma e më tepër janë të letërsisë për fëmijë. Ndërsa për idenë e kësaj ekspozitë Mekolli u shpreh se duan të rikujtojnë autorët e kohës së mëhershme.

“Ideja e kësaj ekspozitë ka qenë që të rikujtojmë autorët dhe veprat e kësaj kohe, e veçanërisht të rikujtojmë dhe nderojmë autorët të cilët i kemi lexuar gjatë shkollimit tonë ku disa nga ata nuk janë më në këtë botë”, përfundoi Bedrije Mekolli. Në këtë ekspozitë gjejmë emra si: Esat Mekulli, Ramiz Kelmendi, Rexhai Surroi, Azem Shkreli, Agim Deva, Ali Podrimja, Ymer Shkreli, e shumë të tjerë. Ndërsa ekspozita do të qëndrojë e hapur deri me 18 prill, pra në mbyllje të Javës së Bibliotekës së Kosovës.

“Agnus Dei” nga Kosova merr çmim në garën me 1.800 filma

Në një garë mes 1.800 filmash nga e gjithë bota, “Agnus Dei” ka triumfuar në kategorinë “best drama film” (Filmi më i mirë dramë).

Filmi me regji të Agim Sopit, që shtjellon raportet midis shqiptarëve e serbëve, tashmë ka edhe një trofe të festivalit “International Euro Film Festival” që mbahet “online” me seli në Marbella të Spanjës. Ky është çmimi i 34-t për filmin e bashkëfinancuar nga Qendra Kinematografike e Kosovës. Festivali organizohet nga “Word Foundation City”, një organizatë joprofitabile që prej 2011-s. Sipas regjisorit Agim Sopi, në letrën elektronike me të cilën organizatorët e kanë njoftuar për çmimin, “Agnus Dei” është cilësuar “film mahnitës”, ndërsa vetë regjisor “filmbërës i shkëlqyer”.

Por Sopi ka paralajmëruar se filmin e tij e presin edhe shumë festivale të tjera.

“Filmi po ashtu ditët e fundit është përzgjedhur që të shfaqet

në programet zyrtare edhe të pesë festivaleve të rëndësishme ndërkombëtare duke e çuar në 91 numrin e festivaleve, pjesë zyrtare e të cilave ka qenë ose do të jetë”, ka thënë Sopi, tek ka shtuar se disa prej festivaleve ku do të shfaqet filmi i tij janë “Los Angeles Cine Fest”, “Connecticut Film Festival”, “New Haven International Film Festival”, “Three Cities International Film Festival” dhe “Digitalmation Film Festival”. Në këtë të fundit “Agnus Dei” është i nominuar për tri çmime, mes së cilave për filmin, regjinë dhe kastën më të mirë. Sopi ka thënë se gjatë muajve prill dhe maj filmi i tij do të jetë pjesë e konkurrencës zyrtare edhe në disa festivale të tjera ndërkombëtare. Më 10 prill filmi do të shfaqet në hapje të festivalit amerikan “Bare Bones



International Film Festival”, që mbahet në Oklahoma. Në festivalin që rangohet në top 20 festivalet më të rëndësishme në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, “Agnus Dei” është i nominuar në katër kategori, duke përfshirë atë

për filmin më të mirë në gjuhë të huaj, dramën më të mirë, aktorin më të mirë për protagonistin Astrit Alihajdaraj dhe çmimin për kinematografi. I dhënë premierë në shtator të vitit 2012, “Agnus Dei” sjell një

rrëfim nga lufta e fundit në Kosovë. Filmi ka për kryeprogonist Petrin, rreth të tridhjetave. Ai bie në dëshpërim me nënën e tij Maria dhe burrin e saj Stojanin në një fshat të Serbisë. Peter është i lindur në Kosovë nga një dashuri e ndaluar midis së ëmës dhe babait të tij shqiptar. Rrëfimi nis në kohën kur marrëdhëniet mes serbëve dhe shqiptarëve janë armiqësore. Qendra Kinematografike e Kosovës e kishte subvencionuar këtë film me 310 mijë euro me buxhetin e vitit 2010. Filmi kishte nisur xhirimet në vjeshtën e atij viti, ndërsa një pjesë e xhirimeve janë kryer edhe në pranverën e vitit 2011.

Rrëfimi për raportet mes shqiptarëve e serbëve, siç paralajmëron Sopi, në maj shpallet edhe në Londër, New York dhe Hong-Kong.



EGNATIA GROUP

OFERTË SPECIALE

28.000 €

5 APARTAMENTET
E FUNDIT

GATI PËR BANIM
ME HIPOTEKË

GARAZHE
& AMBIENTE TREGTARE

KONTAKTONI: 068 2020226, 068 2050264
ISH UZINA E AUTOTRAKTORËVE, 50M MBI TV NEWS24, TIRANË - ALBANIA